

1 E enjte, 1 dhjetor 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [Seancë apeli]

4 [Apeluesi Haradinaj hyn në sallën e gjyqit]

5 [Apeluesi Gucati merr pjesë përmes

6 videolidhjes]

7 --- Seanca fillon në orën 13.30

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirëmëngjes
9 dhe mirë se keni ardhur të gjithë.

10 Znj. Sekretare, ju lutem thërrisni çështjen.

11 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar.

12 Është çështja KSC-CA-2022-01, Prokurori i Specializuar kundër
13 Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

15 Faleminderit, sekretare.

16 Përpara se të fillojmë seancën, Paneli i Apelit do të
17 lëshojë një urdhër me kërkesën e Mbrojtjes së z. Haradinaj për
18 shtyrjen e seancës së sotme.

19 Z. Cadman, Paneli vëren se ju kërkuat një shtyrje por ne
20 nuk mund ta plotësojmë kërkesën tuaj. Ne konstatojmë se këtë
21 seancë mund ta dëgjoni dhe ta përfaqësoni, të përfaqësoni
22 interesin e klientit nga larg.

23 Ne e kuptojmë si Panel se mund ta ndiqni këtë çfarë
24 thuhet këtu përmes videolidhjes. Në rastet që ne do të futemi
25 në seancë private, mesa kuptojmë, ju do të shihni transkriptin

1 në kohë reale dhe mund ta ndiqni atë që thuhet në seancë
2 private, pra, do të keni njohuri për këtë seancë.

3 Gjithashtu Paneli vëren se keni një bashkëmbrojtës,
4 përgjegjësia e të cilës është të përfaqësojë klientin dhe këtë
5 mund ta bëjë gjatë çdo parashtrimi në seancë private.

6 Gjithashtu Paneli supozon se ju jeni në gjendje të
7 shkëmbeni emaile me kolegët në seancë dhe t'u jepni atyre
8 udhëzime.

9 Gjithashtu, Paneli beson se shtyrja e seancës në minutë
10 të fundit do të vonojë në mënyrë të padrejtë procedurat dhe do
11 të ndikojë në detyrën tonë për të siguruar shpejtësi dhe
12 efikasitetin e procedurave.

13 Paneli vëren se ka një precedent në këtë rast ku një
14 kërkesë e tillë e ngjashme është hedhur poshtë nga Trupi
15 Gjykues dhe në çështje të tjera, për shembull, në Mekanizëm,
16 në rastin e Mladiçit, Trupi Gjykues vuri në dukje se kur
17 klienti përfaqësohet nga mbrojtësi dhe bashkëmbrojtësi secili
18 prej tyre mund të marrë përgjegjësi për pjesëmarrje në
19 procedurë.

20 Kjo është edhe më shumë kështu në një situatë të tillë si
21 kjo në një seancë të apelit ku ekipet e ndryshme kanë pasur
22 kohë të mjaftueshme për të përgatitur parashtrimet e tyre për
23 apel, sidomos duke qenë se seanca e apelit është parashikuar
24 në një urdhër të nxjerrë në 20 tetor 2022.

25 Këtu përfundon urdhri ynë me gojë.

1 Vërej se z. Haradinaj është i pranishëm në sallën e
2 gjyqit dhe se z. Gucati do t'i ndjekë procedurat e sotme
3 përmes videolidhjes.

4 Z. Gucati, e dëgjoni procedurën në një gjuhë që e
5 kuptoni? Më dëgjoni? Më dëgjoni?

6 Më dëgjoni, z. Gucati?

7 Z. REES: [Përkthim] Mbase mund t'ia hapin mikrofonin se
8 nuk e ka mikrofonin e hapur.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] A është e
10 mundur që të hapet mikrofonit? Se duket sikur ai më dëgjon por
11 nuk dëgjohet zëri i tij.

12 Z. REES: [Përkthim] Meqë jam në këmbë dhe presim që të
13 zgjidhet, a mund të them diçka në lidhje me z. Gucati, ai
14 është në karrocë. Ai, siç e dini, ka kaluar një operacion dhe
15 synon të vijë nesër personalisht.

16 Për sa i takon sot dhe nesër, i kam thënë që nëse e ka të
17 vështirë të ndjekë procedurat sepse i duhet të bëjë pushim,
18 merr ilaçe për dhimbjet që ka, nëse e ngre dorën do t'ju
19 lutesha që t'i jepnit një pushim të shkurtër.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në qoftë se
21 unë nuk e shoh, ju lutem ma vini në dukje.

22 Z. REES: [Përkthim] Do të bëjmë ç'është e mundur.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Më dëgjoni?

1 APELUESI GUCATI: [Përmes videolidhjes] Po, unë ju ndëgjoj
2 shumë mirë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] NË rregull.
4 Shumë mirë.

5 Z. Haradinaj, i dëgjoni procedurat në një gjuhë që i
6 kuptoni?

7 APELUESI HARADINAJ: I ndigjoj, po.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Tani do t'i
9 lutesha palëve dhe Zyrës Administrative të prezantoheshin,
10 duke filluar nga z. Gucati.

11 Z. REES: [Përkthim] Unë jam Mbrojtësi i Specializuar
12 Jonathan Rees. Mua më ndihmon Huw Bowden, bashkëmbrojtës dhe
13 Eleanor Stephenson. Kemi gjithashtu Muharem Halilaj për të na
14 ndihmuar në punën tonë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mbrojtësi i
16 z. Haradinaj.

17 ZNJ. BERNABEU: [Përkthim] Almudena Bernabeu,
18 bashkëmbrojtëse, bashkë me mbrojtësin Toby Cadman dhe bashkë
19 me ne është edhe Omar Soliman, ndihmës ligjor.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Prokuroria.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar. Unë jam Alex
22 Whiting [sipas përkthimit], Prokuror i Specializuar në detyrë,
23 James Pace, prokuror, Line Pederson, administratore e
24 çështjes, Fabian Unser-Nad, ndihmësprokuror dhe Matt Halling,
25 prokuror.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në këto
2 raste, unë jam Michele Picard, kryegjykatëse dhe në krahun tim
3 të majtë është Nina Jorgensen, në të djathtë Kai Ambos.

4 Kjo çështje ka të bëjë me apelimin e aktgjykimit të
5 Trupit Gjykes nga z. Gucati, kryetar i OVL UÇK-së dhe nga z.
6 Haradinaj, zëvendëskryetar i kësaj organizate në një seri
7 ngjarjesh që kanë ndodhur në periudhën 7 shtator deri në 25
8 shtator.

9 Z. Gucati dhe z. Haradinaj janë të pranishëm dhe apelojnë
10 aktgjykimin e dhënë nga Trupi Gjykes II në 18 maj 2022. Trupi
11 Gjykes konstatoi se secili prej të akuzuarve është fajtor për
12 pesë pika të aktakuzës për vepra të ndëshkueshme sipas ligjit
13 për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Kodit Penal të
14 Kosovës, konkretisht: Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen
15 e detyrave zyrtare përmes kërcënimit serioz, përfshirë formë
16 të rënduar, Pika 1; pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e
17 detyrave zyrtare duke marrë pjesë në veprime të përbashkëta të
18 një grupi, përfshirë dy forma të rënuara për Gucatin dhe një
19 formë të rënduar për z. Haradinaj, Pika 2; frikësimi gjatë
20 procedurave penale, Pika 3; Shkelja e fshehtësisë së
21 procedurave përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit
22 të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, Pika 5; dhe
23 shkeljes së fshehtësisë së procedurave përmes nxjerrës së
24 paautorizuar të identiteteve dhe të dhënave personale të
25 dëshmitarëve të mbrojtur përfshirë formë të rënduar, Pika 6.

1 Trupi Gjykses nuk shpalli vendim fajësie për veprën e
2 hakmarrjes, Pika 4.

3 Trupi Gjykses dënoi si z. Gucati dhe z. Haradinaj me një
4 dënim të vetëm prej katër vjet e gjysëm burg, duke e
5 llogaritur kohën e kaluar këtu dhe një gjobë prej 100 euro.

6 Në apelimet e tyre z. Gucati dhe z. Haradinaj ngrenë,
7 përkatësisht, 20 dhe 24 pika arsye për apel. Ata parashtrojnë
8 se Trupi Gjykses kreu një numër gabimesh në ligj dhe në fakt
9 dhe gabime në dënim.

10 Z. Gucati kërkon nga Paneli i Apelit ta rrëzojë vendimin
11 e fajësisë së tij dhe ta lirojë për të gjitha pikat apo t'ia
12 kthejë çështjen Trupit Gjykses; ose, nga ana tjetër, t'ia uli
13 dënimin.

14 ZPS-ja e kundërshton apelin dhe i kërkon Panelit të
15 Apeleve që të hedhë poshtë çdo arsye dhe të hedhë poshtë atë
16 që kërkohet në apel.

17 Në përputhje me urdhrat për caktimin e datës të dhënë në
18 20 tetor 2022 dhe 7 nëntor 2022, Paneli i Apelit dëgjon apelet
19 kundër aktgjykimit nga z. Gucati dhe z. Haradinaj. Tani do të
20 përmbledh mënyrën në cilën ne do të vazhdojmë.

21 Do t'ju kërkoja palëve dhe procesit që procesi i apelit
22 nuk është një gjyq nga fillimi dhe që palët duhet të mos
23 përsërisin argumentet e tyre të paraqitura në gjykim.
24 Argumentet duhet të kufizohen tek gabimet e pretenduara në
25 ligj të cilat zhvleftësojnë aktgjykimin.

1 Gjatë gjithë seancës, Mbrojtësit mund të argumentojnë
2 arsyet e apelit në çfarëdo mënyre që ata e konsiderojnë të
3 përshtatshme për paraqitjen e tyre. Palët paraqesin
4 parashtrimet e tyre në mënyrë të saktë, të qartë dhe të
5 përmbledhur dhe duhet gjithashtu të japin referenca të sakta
6 për materialet që mbështesin argumentet e tyre me gojë.

7 Gjykatësit, sigurisht, mund t'i ndërpresin palët në çdo
8 moment të bëjnë pyetje, apo mund të bëjnë pyetje pas
9 parashtrimeve të palëve apo në fund të seancës.

10 U kërkohet palëve të mos përsërisin fjalë për fjalë apo të
11 përmbledhin në mënyrë të zgjeruar argumentet me shkrim.

12 Dua t'i kujtoj të gjithëve se duhen respektuar disa
13 rregulla në të gjithë kohën me qëllim për të bërë një proces
14 sa më të saktë.

15 Mbani parasysh nevojën e përkthimit të mirë i cili
16 kërkon kohë pak më shumë ndonjëherë pasi ju të keni mbaruar së
17 foluri. Ju lutem mos harroni të përdorni mikrofonat. Kjo
18 seancë paraqitet e transkriptuar në kohë reale dhe do të
19 pasqyrohet në transkript i cili do të jetë i disponueshëm për
20 palët dhe për publikun.

21 U kujtoj palëve të njoftojnë paraprakisht në rast se
22 ndonjë parashtrim i tyre kërkon nxjerrjen e informacionit
23 konfidencial me qëllim që të futemi në seancë private apo të
24 mbyllur. Dëshiroj t'u kujtoj palëve të jenë shumë të
25 kujdesshëm të mos nxjerrin asnjë informacion që mund të

1 identifikonte një dëshmitar të mbrojtur.

2 Në pajtim me urdhrin e 7 nëntorit që përcakton programi
3 për sot, do të vijojmë si më poshtë.

4 Sot do të dëgjojmë parashtrimet nga Mbrojtësi i z. Gucati
5 për një orë e 30 minuta. Pas një pushimi prej 30 minutash do
6 të dëgjojmë parashtrimet e Mbrojtësit e z. Haradinaj
7 gjithashtu për një orë e 30 minuta.

8 Ndërsa nesër, duke filluar në orën 9.30, ZPS-ja do t'i
9 përgjigjet z. Gucati dhe z. Haradinaj për dy orë gjithsej. Dhe
10 pas një pushimi 30 minuta, Mbrojtësit e z. Gucatit dhe z.
11 Haradinaj do të kenë secili 20 minuta për kundërpërgjigje. Pas
12 kësaj, z. Gucati dhe z. Haradinaj do të kenë rastin të thonë
13 diçka personale, shkurtimisht, para Panelit.

14 Pasi përcaktuam mënyrën si do të vazhdojmë, ftoj
15 Mbrojtësin e z. Gucati të paraqesë apelin e tij.

16 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, z. Gucati ka 797
17 ditë, pra, 26 muaj dhe pesë ditë apo gjashtë ditë, pasi është
18 arrestuar në 25 shtator 2020.

19 E filloj duke ju referuar kohës që ai ka kaluar, meqenëse
20 kemi vetëm një orë e gjysëm, kërkoj që të përqendrohëm në
21 parashtrimet e mia gojore, duke iu referuar kohës që ai ka
22 kaluar dhe strukturës së dënimit.

23 Është e qartë, që Trupi Gjykues, pra, dha vendimin, por
24 nuk tregoi sesi arriti në atë vendim. Lidhur me shpalljen
25 fajtor për Pikat 1 deri në 5, përfshirë formën e rënduar ata

1 kanë dhënë një vit me burg për Pikën 6, përfshirë formën e
2 rënduar, dy vjet; për Pikën 3, katër vite.

3 Lidhur me Pikat 1, 2, 5, dhe 6, z. Gucati ka qenë i
4 ndaluar për më shumë sesa Trupi Gjykues tha përshtatej për ato
5 pika.

6 Do të përqendrohem tek Pika 3 sot, duke u fokusuar ke
7 nxitja për kryerjen e një vepre penale dhe apelin e dënimit që
8 ne paraqesim sot.

9 Pikat përkatëse janë 1, 2 dhe 3; 17, 18, dhe 19; dhe
10 arsyet 20. Këtë do ta bëj për të gjitha parashtrimet. Që nuk
11 do të thotë se mospërmendja e arsyeve të apelit që janë në
12 dosjen tonë dhe në njoftimin e apelit, janë, po ashtu, njëlloj
13 të vlefshme dhe ju kërkojmë që të vendosni edhe për këto arsye
14 apeli, duke pasur parasysh parashtrimet me shkrim që ne kemi
15 paraqitur në dosje në kundërpërgjigje. Por për qëllimet e
16 sotme, meqë kemi një orë e gjysëm për parashtrime me gojë, do
17 të përqendrohem në apelin lidhur me Arsyen 3, që është
18 frikësimi, ku Trupi Gjykues tha që katër vjet janë të
19 përshtatshme dhe nxitja për kryerjen e një vepre penale ajo
20 gjithashtu lidhet me Arsyen 3; dhe pastaj apelimi i dënimit.

21 Duke ju kthyer Pikës së arsye 1. Dua t'i kthehem fjalëve
22 të Trupit Gjykues lidhur me nenin 387 të Kodit Penal të
23 Kosovës që përcakton vetëm alternativën e tretë dhe nuk e
24 kufizon zbatimin e të gjithë dispozitës.

25 Ne themi se kërcënimi i rëndë për qëllimin e këtij neni

1 nuk kufizohet vetëm me kërcënimin për të përdorur forcë por
2 përfshinë edhe kërcënimin për të shkaktuar dëm për shëndetin,
3 sigurimin, privatësinë e personit.

4 Ata thonë që ky kërcënim për të përdorur fjalët ishte
5 baraz me një kërcënim të rëndë. Dhe ne kundërshtojmë
6 konstatimin e tij se neni 387 i Kodit Penal të 2019 nuk
7 kërkonte prova që një person nxitej për të bërë një deklaratë
8 të rreme përpara prokurorit, policisë apo një gjykatësi.

9 Dhe, së fundi, për të konstatuar që është përmbushur akti
10 i *actus reus* dhe duam ta bëjmë këtë dhe për të treguar se çdo
11 person zhbndet për të kryer një krim. Ndërsa vetë neni 378,
12 vetë ky nen, pra, ka të bëjë me pengimin e procedurave penale.

13 Juve i njihni termat, mënyrën sesi është formuluar neni
14 387 i Kodit Penal të Kosovës. Trupi Gjykues sugjeroi se ishte
15 qëllimi i Mbrojtjes për të kriminalizuar përdorimin e forcës
16 apo kërcënimin e rëndë apo për të mos dhënë informacion të
17 duhur. Por është e qartë nga vepra se ka të bëjë me procedura.
18 Nuk është një vepër penale që të shtysh një person të bëjë një
19 deklaratë të çdo lloji apo të bëjë një deklaratë të rreme
20 përpara një personi apo të mos tregojë informacionin e duhur.
21 Kjo është një sjellje që nuk futet brenda kuadrit të nenit
22 387, i cili thotë, ka për qëllim dhe bën dhe kufizon
23 përdorimin e forcës apo kërcënimin e rëndë për të nxitur një
24 person të japi një deklaratë të rreme apo të mos tregojë të
25 vërtetën përpara policisë, apo gjykatësit, apo hetuesit.

1 Sigurisht, vetë neni nuk përsërit fjalët gjithmonë lidhur
2 me këtë, tre alternativat. Por është e qartë se këto fjalë
3 përcaktojnë se cilët nga tre alternativat, pra, mosbërja e një
4 deklaratë, bërja e një deklaratë të rreme apo mosbërja e një
5 deklaratë të vërtetë. Të gjitha ato kanë një përcaktues, pra,
6 është në kuadrin e dhënies së deklaratave apo dhënies
7 informacionit policisë, gjykatësit.

8 Njëlloj si këto fjalë e kufizojnë zbatimin e gjithë
9 dispozitës, ne themi, se fjalët "lidhen dhe me pengimin e
10 procedurës penale". Informacioni që i nënshtrohet deklaratës
11 që jepet apo është objekt i një deklaratë të rreme apo është
12 objekt i një informacioni të vërtetë që nuk jepet, duhet
13 lidhur, sipas nenit 387, me pengimin e procedurave penale.

14 Pengimi i procedurave është një term që në vetvete është
15 një vepër. Sipas 386 është e vërtetë. Është e vërtetë, pengimi
16 i procedurës sipas 386 nuk kufizohet vetëm me procedurat
17 penale por i përfshinë ato si mbas objektit të nenit 387.

18 Trupi Gjykses, në analizën e vet, duke hedhur poshtë
19 parashtrimet e Mbrojtjes dhe duke thënë se këto fjalë
20 kufizonin vetëm alternativën e tretë, pra, dhënien e
21 informacionit të vërtetë, ata kanë parë pararendësin e nenit
22 387, 310 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës të 2003. Ai
23 nen, që në pamje të parë, është pararendësi i vetë nenit 387,
24 ai është i kufizuar për informacione të lidhura me krimin e
25 organizuar.

1 Znj. Sekretare, a mund të shohim nenin 310 të Kodit Penal
2 të Kosovës?

3 E kemi të gjithë kodin. Sigurisht, ju keni qasje në të
4 dhe nuk e di nëse e keni parë përpara seancës së sotme.

5 Neni 310 parashikon që:

6 "Kushdo që përdor forcë, kërcënim për forcë apo për çdo
7 mjet detyrimi, premtim i një dhurate për të nxitur një person
8 për të mos bërë një deklaratë apo për të dhënë deklaratë të
9 rreme apo ndryshe të mos të thotë të vërtetën policisë, a
10 prokurorit, apo një gjykatësi, kur një informacion i tillë
11 lidhet me krimin e organizuar dënohet me një gjobë prej..."

12 Dhe e tregon se çfarë gjobe.

13 Ky nen quhet "Frikësim gjatë procedurave penale në rastin
14 e krimit të organizuar" dhe është e qartë, se për Trupin
15 Gjykses ishte e qartë, se fjalët se "kur ky informacion lidhet
16 me krimin e organizuar", nuk kufizonin thjesht fushëveprimin e
17 alternativit 3 të nenit 310 që "mosdhënia e informacionit të
18 vërtetë prokurorit, policisë, apo gjykatësit". Ajo përcaktonte
19 se cilën nga alternativat, pra, që një veprë penale sipas
20 nenit 310, kur personi ka përdorur forcë për ta nxitur një
21 person të mos jepte deklaratë kur një informacion lidhet me
22 krim të organizuar apo të japë një deklaratë të rreme kur një
23 informacion i tillë lidhet me krimin e organizuar apo ndryshe
24 të mos japë informacion të vërtetë kur një informacion i tillë
25 lidhet me krimin e organizuar, sigurisht, në kontekstin e

1 dispozitës së këtyre çështjeve përpara, pra, gjykatësit,
2 policisë apo prokurorit.

3 Neni 387, në rastin në bazë të së cilit është dënuar edhe
4 z. Gucati, është ekzaktësisht i njëjti, me të njëjtat terma,
5 me të njëjtat fjalë, saktësisht me të njëjtin format dhe
6 vendosje në formulim sipas fjalëve të Trupit Gjykses, i nenit
7 310, me përjashtim që tek fjalët kur thuhet "lidhet me krimin
8 e organizuar" janë zëvendësuar me fjalët "kur një informacion
9 lidhet me pengimin e procedurave penale".

10 Neni 309 i Kodit Penal Provizor, i referohet pengimit të
11 dëshmisë, sikurse bën dhe neni 387 i Kodit Penal aktual. Ne
12 themi se parashtrimi i Prokurorisë në paragrafin 61 të
13 përgjigjes së tyre -- sa do t'ju kujtoj paragrafin ku ndodhet.
14 Ata parashtrojnë se:

15 "Do të ishte pasojë e interpretimit që ne mendojmë se
16 është interpretimi i duhur. Pasojë e nevojshme do të ishte
17 krimi nëse personi i frikësuar ka të bëjë me pengimin që
18 parashikohet në nenin 386".

19 Ata mund të akuzohen sipas veprës të parashikuar në nenin
20 386 në qoftë se janë përfshirë në frikësimin e dëshmitarëve
21 lidhur me procedurat në përgjithësi, pavarësisht nëse
22 kufizohen ose jo me procedurat për pengim. Në qoftë se pasoja
23 apo efekti është që vetëm dëshmitarë që kanë informacion për
24 krim të organizuar mund të frikësohen sipas atij Kodi Penal të
25 2003, atëherë, në pamje të parë, është atë që ka parashikuar

1 ky kod.

2 Ne themi, në fakt, se Kodi Provizor, siç është ai i 2019,
3 sigurisht, parashikojnë frikësimin e dëshmitarëve jashtë
4 objektit të krimit të organizuar. Dhe këtë e ka bërë në nenin
5 309 të kodit. Neni 309 parashikonte, për shembull, se ka tre
6 palë, por ne po lexojmë të parën.

7 1. "Kushdo, që përmes përdorimit të forcës, kërcënimit
8 për të përdorur forcë, detyrimit apo premtimit të një dhurate
9 apo të ndonjë përfitimi tjetër e nxit dëshmitarin të japë
10 dëshmi të rreme" dhe të tjera dhe "dënohet me burg...".

11 Sigurisht edhe pse frikësimi sipas nenit 310 është i
12 kufizuar me frikësimin ku informacioni kishte të bënte me
13 krimin e organizuar, neni 309 ka parashikuar për frikësimin e
14 dëshmitarëve në përgjithësi dhe në procedura penale. 306
15 ekzatësisht thotë këtë gjë.

16 Interpretimi që bëri Trupi Gjykses, i cili, sigurisht,
17 ishte i nevojshëm ta bënte këtë interpretim në qoftë se donin
18 ta dënonin z. Gucati për Pikën 3 sepse, sigurisht, nuk kishte
19 dëshmi për ndonjë dëshmitar të përfshirë në këtë çështje i
20 cili të kishte informacion lidhur me pengimin e procedurave
21 penale sipas nenit 386. Pra, përdorimi i ngushtë i këtij
22 përcaktuesi vetëm në Pikën 3 të 386 nuk ka asnjë bazë, për
23 mendimin tim, nuk është bazë e duhur për interpretim, nuk ka
24 bazë. Nuk ka themel sepse të shpie në bërjen e një dallimi të
25 çuditshëm. Në qoftë se kanë të drejtë, pra, kur thonë që nxit

1 një dëshmitar për të dhënë një deklaratë të rreme, në këtë
2 rast pengimi do të ishte një vepër penale. Por, duke e nxitur
3 një dëshmitar - përmes përdorimit të forcës apo kërcënimit për
4 forcë - që të mos thotë informacion të vërtetë apo të mbajë
5 informacionin mos t'ia tregojë policisë, në vepra jopenguese
6 nuk do të ishte vepër penale sipas këtij neni. Pra, nuk ka
7 asnjë kuptim. Nuk ka asnjë bazë.

8 Nuk ka asnjë bazë edhe kur ajo që përbën një deklaratë të
9 dëshmitarit sipas qëllimit të procedurave nuk është forma, nuk
10 është nëse në krye të faqes thotë "Deklaratë e Dëshmitarit"
11 apo jo. Por rregullohet, përcaktohet nga thelbi, nga
12 substanca, përmbajtja. Funkzioni i përmbajtjes së
13 informacionit që përmban, qëllimi i saj dhe burimi i këtij
14 informacioni. Dhe, sigurisht, në kuadrin e procedurave penale,
15 kur deklarata e dhënë nga një dëshmitar dhe informacioni i
16 dhënë nga një dëshmitar janë njëlloj, pritet njëlloj të jenë
17 të vërteta.

18 Trupi Gjykses konstatoi se *actus reus* i nenit 387
19 kërkonte dy elemente. Dhe është fjala tek paragrafi 109 i
20 aktgjykimit. Për ta kujtuar i referohemi paragrafit 109. Dhe
21 thuhet që Trupi Gjykses konstaton se:

22 "Vepra e frikësimit brenda kuptimit të nenit 387 kërkon
23 si më poshtë -

24 Znj. përkthyes, do të bëjë më të mirën e mundshme.
25 Megjithatë, siç e dini, kemi kohë të kufizuar kështu gjithsesi

1 premtoj që do të bëj më të mirën e mundshme për të folur më
2 ngadalë.

3 Atëherë parashikohen elementët e mëposhtëm:

4 "Përdorimi i forcës, si kërcënimit të rëndë, ose ndonjë
5 mënyrë tjetër detyrimi, premtim për dhuratë ose ndonjë
6 përfitim tjetër, kundër çdo personi që ka të ngjarë të japë
7 një deklaratë ose të japë deklaratë përpara organeve policore,
8 prokurorit apo gjyqtarit".

9 Dhe këtë, në fakt, e kanë përsëritur edhe në paragrafin
10 557. Trupi Gjykues do të vlerësojë në qoftë se të akuzuarit
11 kanë bërë ndonjë kërcënim kundër personave që kanë të ngjarë
12 ose që do të bëjnë një deklaratë ose të japin informacion për
13 një polic, prokuror ose gjyqtar.

14 Pra, konstatimi duke e lidhur me atë çfarë parashikohet
15 në këto dy paragrafë dhe materiale që do të çojnë në
16 vlerësimin e sjelljes së të akuzuarve, u bë i tillë që Trupi
17 Gjykues ka lënë mënjanë dy elementë të veprës penale të cilat
18 janë të dukshme. Pra, kjo nuk mund të jetë e debatueshme, nuk
19 është se ka ndonjë çështje të diskutueshme lidhur me këtë. Nuk
20 i referohem çështjeve të cilat janë të parashtruara nga ne,
21 por gjëra të cilat janë kërkesa të paramenduara.

22 Pra, Trupi Gjykues injoroi, nuk mori parasysh kërkesën që
23 neni 387 kërkon ofrimin e informacionit tek policia, prokurori
24 ose gjyqtari. Dhe këtë nuk e përmendëm fare. E lanë fare
25 mënjanë duke mos e përmendur fare këtë. Ndërkohë që sa i takon

1 hakmarrjes, Trupi Gjykues tha që Prokuroria nuk ka parashtruar
2 ndonjë provë për të vërtetuar që ka ndonjë vërtetësi në
3 informacionet që pretendoheshin që të jepeshin nga
4 dëshmitarët. Pra, në këtë rast nuk u tha që këto ishin
5 parashtrime të dëshmitarëve.

6 Domethënë, me fjalë të tjera, u hoq fjala "të vërteta"
7 nga grupfjala "dhënia e informacionit të vërtetë apo të saktë
8 një prokurori, polici ose prokurorit [sipas përkthimit]". E
9 njëjta gjë është bërë edhe me togfjalëshin që ka të bëjë me
10 pjesën e "pengimit të procedurave penale". Kjo në vetvete nuk
11 është se ka asnjë lloj kuptimi edhe në konstatimet e veta.
12 Konstatimet e Trupit Gjykues, formulimi që "kur një
13 informacion i tillë që ka të bëjë me pengimin e procedurave
14 penale" të paktën kualifikohet për alternativën e tretë të
15 kodit, pra, të nenit përkatës së kodit; domethënë, alternativa
16 e mosdhënies së informacionit të saktë për organet e policisë,
17 për Prokurorinë dhe për gjyqtarët.

18 Dhe, pra, kur bënë vlerësimin e sjelljes së të akuzuarve,
19 u hoq fjala "të vërteta" kur u bë vlerësimi i informacionit që
20 nuk është nxjerrë ose që nuk i është bërë me dije informacioni
21 dhe gjithashtu nuk u përdorë as togfjalëshi "për pengimin e
22 procedurave gjyqësore".

23 Kjo përbën problem në parashtrimin tonë, sa i takon
24 caktimit të dënimit për Pikën 3, sepse sipas konstatimeve të
25 vetë Trupit Gjykues, e vetmja gjë që mund të thoshte Trupi

1 Gjykues është që deklaratat e të akuzuarve mund të kishin
2 krijuar frikëra dhe shqetësime të rënda për persona të cilët
3 kishin dhënë prova ose mund të kishin gjasa që të jepnin prova
4 të tilla, duke ç'inkurajuar persona që të jepnin informacion
5 që kishte të bënte me krimet që binin në fushën e
6 juridiksionit të Dhomat e Specializuara.

7 Dua të ndaloj një moment këtu. Është e rëndësishme që të
8 jepen disa shpjegime se pse Trupi Gjykues i është referuar
9 dizinkurajimit ose shkurajimit të informacionit -- shkurajimit
10 të një personi për të dhënë informacion. Sepse, ndërkohë,
11 Trupi Gjykues ka bërë dallimin ndërmjet frikësimit dhe
12 hakmarrjes. Sepse hakmarrjen e ka parë në raport me provat e
13 ZPS-së. Dhe këto nuk janë elementë të cilët kanë të bëjnë me
14 hakmarrjen. Sepse hakmarrja ka të bëjë me diçka që mund të
15 ndodhë në të armen, domethënë, që të parandalohet dhënia e një
16 deklaratë në të shkuarën dhe qëllimi është që të mos jepet
17 deklarata ose mund të nxiten që të jepet një deklaratë e
18 rreme. Domethënë, nuk e kanë dhënë këtë deklaratë, por nxiten
19 që të japin një deklaratë të tillë të rreme ose të mos japin
20 një informacion të saktë për organet e përmendura më sipër.

21 Në këtë paragraf, së pari, duhet të nënvijëzohet që Trupi
22 Gjykues asnjëherë nuk e ka përmendur një person i cili është
23 nxitur ose që ka qenë objekt i kërcënimit të rëndë nga dikush
24 në mënyrë të tillë që të mos japë një deklaratë të caktuar ose
25 për të dhënë një deklaratë të rreme. Kështu që në këtë

1 paragraf të aktgjykimit, ku përmenden personat që kanë dhënë
2 dëshmi, këto persona nuk janë në fushën e veprimit të Pikës 3.
3 Pra, në fakt, ato bien nën pikën e mëparshme, hakmarrjen dhe
4 Trupi Gjykses ka shpallur të dy të akuzuarit jo fajtor për
5 këtë pikë.

6 Pra, personat në paragrafin e gjetjes ose konstatimit të
7 Trupit Gjykses janë persona të cilët do të jepnin informacion
8 për krimet të cilat janë pjesë e fushës së veprimit të
9 juridiksionit të Dhomat e Specializuara.

10 Pra, Trupi Gjykses u mbështet dhe shpalli fajtorë të
11 akuzuarit për alternativën e tretë, të tre hapat të cilët
12 parashikohen në nenin 387; në këtë rast është përdorimi i
13 kanosjes së rëndë, në mënyrë të tillë që të nxiten personat që
14 të mos japin informacion që kanë të bëjnë me krime që janë
15 pjesë e fushës së veprimit të juridiksionit të Dhomave të
16 Specializuara.

17 Dhe, ndërkohë që janë mbështetur tek alternativa e tretë,
18 Trupi Gjykses ka lënë mënjanë, nuk ka marrë parasysh tre
19 alternativa; pra, ata nuk kanë marrë dy aspekte parasysh,
20 domethënë, në kuadrin që ky informacion duhet të ishte
21 informacion i saktë dhe informacioni duhej që të lidhej me
22 pengimin e procedurave gjyqësore. Dhe veprën që parashikohet
23 në nenin 386, që është një vepër penale që ekziston më parë,
24 pra, që është e parashikuar në një nen të mëparshëm, në nenin
25 386.

1 Këto dy elemente janë shumë të rëndësishëm, janë përbërës
2 shumë të rëndësishëm të nenit 387, si për shembull,
3 informacioni i mëtejshëm që kishte të bënte me shkurajimin dhe
4 që duhej që të lidhej me pengimin e procedurës penale dhe
5 duhet të ishte informacion i vërtetë, në mënyrë të tillë, që
6 të kualifikohej përdorimi i nenit 387. Këto tipare nuk janë të
7 pranishme as në analizën e Trupit Gjykues edhe as në provat që
8 kemi dëgjuar përpara Trupit Gjykues. Nuk është ndonjë çudi që
9 këto nuk janë reflektuara në vendimin e marrë nga Trupi
10 Gjykues, sepse nuk kemi marrë prova sa i takon informacionit
11 që do të çonte në shkurajimin e dikujt që të kryente veprat të
12 cilat janë të parashikuar në 386 dhe nuk mund të arrihej në
13 përfundimin që ky informacion ishte i vërtetë.

14 Sigurisht, tek pjesa e parashtrimeve tona, ne kemi
15 ngritur çështjen që neni 386 mund të ketë të bëjë me veprën e
16 përgjithshme të frikësimit. Domethënë, kjo është e dukshme, që
17 në pamje të parë të kësaj dispozite, të nenit 386. Neni 386
18 thotë që:

19 "Përmes përdorimit të shtrëngimit" që mund të përfshijë
20 këtu edhe përdorimin e forcës ose kanosjes për forcë edhe mund
21 të jetë e mundur që të përdoren edhe të përfshihen mjete të
22 tjera të shtrëngimit.

23 Në nenin 386, do të doja që ta tregonit në ekran nenin
24 386, e nderuar znj. Sekretare. Nuk e kemi.

25 Atëherë jam i sigurtë, gjithsesi, pavarësisht që nuk e

1 kemi në ekran që i dini këto dispozita dhe rrjedhën e tyre.

2 Megjithatë, neni 386 parashikon kur, në fakt, përdoret
3 një dhuratë ose një pengesë tjetër sa i takon personit për sa
4 i takon dhënies së informacionit për procedurë penale. Në
5 fakt, ka mënyra të ndryshme ose forma të ndryshme të
6 frikësimit të cilat parashikohen në kuadrin e përgjithshëm të
7 nenit 386.

8 Nuk po i largohem faktit që po përmendim, domethënë,
9 referimi i nenit 386, në parashtrimin tim, nënkupton që mund
10 të ketë një mënyrë tjetër të gjykimit. Megjithatë, them, që
11 lidhur me parashtrimin tim, le të themi: Do ishte e gabuar që
12 vendimi i dënimit të mbështetej në nenin 386 sepse z. Gucati
13 nuk është akuzuar për shkelje të këtij neni. Dhe, nuk është
14 bërë absolutisht asnjë lloj parashtrimi nga Prokuroria, në
15 mënyrë të tillë, që të mund të ndryshohet aktakuza dhe baza
16 ligjore nga 387 tek neni 386. Megjithëse Prokuroria ka pasur
17 gjithë kohën e nevojshme, jo vetëm kaq, por Prokuroria
18 asnjëherë nuk e ka ngritur këtë gjë, sipas parashtrimit tonë,
19 sepse ata e kanë parashikuar, ashtu siç ka bërë dhe Gjyqtari i
20 Procedurës Paraprake dhe Trupi Gjykues, që neni 386 kërkon
21 provë që një person që bie në Pikën 1, pra, duhet që,
22 domethënë, një person të shkaktojë, le të themi, dhënien e një
23 deklarate të rreme, pra, është e rëndësishme që të kërkohet
24 prova e pasojës. Dhe për këtë arsye, Prokuroria nuk ka bërë
25 akuzën mbi bazën e nenit 386 dhe ka bërë parashtrimin ose

1 shpjegimin e vetë të dallimit ndërmjet nenit 386 dhe 387.

2 Në parashtrimin tonë, Prokuroria nuk vendosi që të merrte
3 prova, sepse nuk kishte prova të tilla që vërtetonin që dikush
4 të nxitej që të mos jepte dëshmi, ose të jepte një deklaratë
5 të rreme, ose të jepte informacion të rremë, ose në mënyra të
6 tjera të mos jepnin informacion të saktë. Kështu që, për
7 rrjedhojë, prova e pasojës, në këtë rast, pra në rastin tonë,
8 në kuadrin e nenit 386, nuk mund të qëndrojë, kështu që, kjo
9 nuk mund të bëhet, në fakt, as në rastin e nenit 387, se neni
10 387 është i lidhur me 386. Për këtë arsye Prokuroria zgjodhi
11 që të ndiqte shtegun e përdorimit të nenit 387 dhe jo atë të
12 përdorimit të nenit 386.

13 Këto gabime lidhur me *actus reus* për Pikën 3 e bëjnë të
14 zhvlefshme konstatimin e Trupit Gjykues që kemi praninë e
15 *actus reus* ose të aktit penal. Ndërkohë, që ne mendojmë, që
16 dënimi për Pikën 3 duhet të prapësohet.

17 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Z. Rees, dy ose tre pyetje?
18 Sa i takon nenit 387, nëse të kuptojmë drejt, ju thoni që
19 elementi i pengimit pas fjalës "kur" zbatohet për tre
20 alternativat. Ky është parashtrimi juaj?

21 Z. REES: [Përkthim] Po.

22 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Atëherë, si e shpjegoni që
23 përmendja e informacionit tek kjo pjesë e nenit, pra, kur
24 thuhet "kur ky informacion lidhet" dhe pastaj vazhdon neni,
25 reflektohet vetëm në alternativën e tretë kur thuhet

1 "informacion i vërtetë"? Si shkon kjo me argumentin tuaj, si
2 lidhet kjo me argumentin tuaj që lidhet me të tre alternativat
3 jo me alternativën e tretë? Kjo është pyetja e parë.

4 Z. REES: [Përkthim] Më lejoni t'i përgjigjem kësaj.

5 Sepse hartuesit e nenit 387 pranojnë, njohin se nuk ka
6 dallim material ndërmjet një deklaratë ose ofrimit, dhënies së
7 informacionit për qëllime të procedurës gjyqësore, të procesit
8 gjyqësor. Ajo çfarë përbën një deklaratë nuk përcaktohet nga
9 forma e saj, por, në fakt, domethënë, kjo lidhet ngushtë me
10 përmbajtjen, me funksionin, me qëllimin dhe me burimin.

11 Dhe, në fakt, këtë e kemi bërë të qartë dhe në
12 parashtrimin 334 dhe, në fakt, kam marrë formulimin e Trupit
13 Gjykses, sepse kjo kishte të bënte me një aplikim për pranimin
14 e dokumenteve, përmes mocionit të paraqitjes së dokumenteve
15 drejtpërsëdrejti në Trupin Gjykses dhe dokumente jo gojore
16 dhe, ndërkohë, Prokuroria kërkoi, pra, që të mund të
17 përdreshin notat ose "Shënimet e Kontaktit". Dhe u tha nga
18 Trupi Gjykses, që është e rëndësishme, që në fakt, të merret
19 parasysh qëllimi dhe burimi, si dhe përmbajtja.

20 Dhe megjithëse fjala "informacion", pra, duket si në
21 përcaktues dhe në alternativën e tretë, informacioni është
22 pjesë e thelbit ose përmbajtjes nga përmbajtja, nga dhënia e
23 informacionit ose përmbajtja nga dhënia e informacionit të
24 rremë.

25 Kështu që, për këtë arsye, kjo ka qenë e parashikuar dhe

1 në nenin 310 të Kodit Provizor, sepse neni 310, që ka të bëjë
2 me "frikësimin në procedurat penale kundër krimit të
3 organizuar", nuk sugjeron që kjo, në fakt, të kufizohet vetëm
4 tek rastet që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, për aq
5 kohë sa nuk ka pasur kundërshtim të kësaj dhe Trupi Gjykses
6 duket sikur ka marrë këtë rrjedhë, këtë drejtim, por
7 informacioni i nenit 310, "kur një informacion i tillë lidhet
8 me krimin e organizuar" nuk lidhet vetëm thjesht me
9 alternativën e tretë në këtë dispozitë, që ka të bëjë me
10 "mosdhënien e informacionit të vërtetë për organet policore,
11 prokurorin, ose gjyqësorin". Por në rastin e "krimit të
12 organizuar" kemi të bëjmë edhe "nxitjen e një personi e
13 mosdhënies të një deklaratë të rreme ose të bëhet një
14 deklaratë e rreme, pra, të mos jepet dëshmi ose të bëhet
15 deklaratë e rreme".

16 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Z. Rees, thjesht po
17 përsërisni atë që thatë pak më përpara. Kush janë "hartuesit"
18 këtu?

19 Z. REES: [Përkthim] Mendoj që hartuesit mund të jenë të
20 ndryshëm. Nuk mund të jenë të njëjtit persona. Megjithatë
21 është ndjekur e njëjta logjikë siç është parashikuar në nenin
22 310 të Kodit Provizor.

23 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Kur thoni hartues e keni
24 fjalën organin ligjbërës? Ke ndonjë person ose ndonjë organ
25 parasysh?

1 Z. REES: [Përkthim] Pra, siç e thashë edhe më përpara, e
2 rëndësishme është që të shikohen formulimet ose fjalët e nenit
3 dhe të shikohet në qoftë se, pra, synimet e hartuesve të
4 ligjit në fjalë përmbushen. Domethënë, kjo është ajo çfarë
5 nënkuptohet me konstrukcion statutor ose, le të themi, me
6 mënyrën e ndërtimit të ligjeve.

7 Pra, ajo çfarë po them unë është që, në qoftë se do
8 shikojmë nenin 387, pra, është -- dispozitat e 387 janë marrë
9 tërësisht nga 310 e Kodit Provizor. I vetmi ndryshim është që
10 "kur ky informacion ka të bëjë me krimin e organizuar",
11 ndërkohë që ky kufizim është zëvendësuar me të njëjtin
12 formulim, që ka të njëjtën rëndësi, që formulimi përkatës
13 është "pengimi i procedurave penale"; domethënë, ky është
14 dallimi i vetëm që ekziston ndërmjet nenit 387 dhe 310 të
15 Kodit Provizor.

16 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Atëherë, sa i takon "bërjes
17 së deklaratës" alternative. Kjo deklaratë, sipas mendimit
18 tuaj, duhet të jetë e vërtetë?

19 Z. REES: [Përkthim] Po.

20 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Po, po nuk thuhet kështu në
21 dispozitë.

22 Z. REES: [Përkthim] Kërkohet që të deklarohet në mënyrë
23 specifike, në mënyrë konkrete, që informacioni që kryesi synon
24 që të nxisë dikë tjetër që të mos i japë dëshmi duhet të jetë
25 i vërtetë. Kështu që neni 387 parashikon ekzaktësisht këtë

1 gjë. Dhe nuk mund të ketë dallim, për sa i takon themelit,
2 lidhur me t'i kërkosh personit ose kryesit që të nxisë dikë që
3 të mos japë dëshmi ose të mos japë informacion të saktë dhe
4 pastaj të mos kërkohet i njëjti synim ose e njëjta vërtetësi
5 lidhur me përmbajtjen e deklaratës.

6 Në fund të fundit, pavarësisht që formulimi "mosbërja e
7 deklaratës" dhe ato nuk janë të paraprirra nga fjala "e
8 vërtetë", megjithatë mosdhënia e deklaratës ose "dhënia e
9 deklaratës së rreme" në vetvete është e barabartë me dhënien e
10 një deklaratë të vërtetë.

11 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Pra, thjesht, po vras mendjen
12 se pse hartuesit nuk e shtuan deklaratën e dytë duke ju
13 referuar këtu deklaratës së rreme, sepse po të ndiqnin
14 logjikën tuaj i takonte që elementi i dytë, domethënë, pjesa e
15 dytë do ishte e tepërt.

16 Z. REES: [Përkthim] Hartuesit nuk bëjnë dallimin ndërmjet
17 informacionit dhe deklaratës. Ata mendojnë që thelbi është i
18 njëjti.

19 Ndërkohë që është deklaruar që informacioni duhet të jetë
20 i vërtetë me logjikë, nënkuptohet që edhe deklarata duhet të
21 jetë e tillë sepse, në mënyrë të kuptimshme, neni 387, ashtu
22 siç edhe neni 310 i Kodit Provizor, e bën frikësimin e
23 dëshmitarëve për ta shtyrë, nxitur dikë që të bëjë një
24 deklaratë, pra, e parashikon këtë si vepër. Dhe një person në
25 qoftë se frikëson dikë, pra, një dëshmitar, kjo parashikohet

1 si vepër penale apo që të nxisë një person që të mos japë
2 informacion. Pra, nuk thuhet që të nxisë një person që të japë
3 informacion të rremë.

4 Dhe prandaj, për logjikë, pra, rezulton në parashtrimet
5 tona që është një vepër sipas nenit 387, ashtu siç
6 parashikohet ekzaktësisht në nenin 310 të Kodit Provizor, pra,
7 që të përdoret detyrimi që ta përmbajë dikush nga dhënia e një
8 deklaratë të rreme, sepse kjo nuk parashikohet
9 drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të shprehur, le të themi, në
10 dispozitën në fjalë.

11 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit shumë.

12 Pyetja e tretë që kam për juve është si më poshtë. Juve
13 thatë për pasojën, folët për pasojën ose provë të pasojës.
14 Duke ju referuar nenit 387, cila është pasoja që sillet nga
15 kjo dispozitë?

16 Z. REES: [Përkthim] Ne parashtrojmë se pasojat e ndaluara
17 në nenin 387 është që peroni të nxitet nga përmbajtja, nga
18 mosbërja e deklaratës dhe mosdhënies së deklaratës së saktë,
19 ose të shtyhet ose të nxitet që të japë një deklaratë të rreme
20 ose të mos japë informacion të saktë për organet përkatëse,
21 pra, kur të gjitha këto informacione kanë të bëjnë me pengimin
22 e procedurës penale.

23 Domethënë, ne e parashtrojmë që kjo është pasoja e
24 ndaluar dhe këtë pasojë duhet që të kishte provuar Prokuroria
25 dhe Prokuroria nuk e bëri këtë gjë, pra, nuk e vërtetoi këtë

1 pasojë.

2 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Në rregull. Lidhur me këtë
3 pikë, kjo do të thotë që, në qoftë se dikush bën një kanosje
4 ndaj një personi, ndaj një dëshmitari, për shembull, dhe ky
5 person, pavarësisht kanosjes, e jep deklaratën, që mund të
6 jetë e vërtetë, jo e vërtetë, gjithsesi, domethënë ju po thoni
7 që kjo nuk bie në nenin 387 apo jo?

8 Z. REES: [Përkthim] Po.

9 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Po. Se ju thoni që kërcënimi
10 ose kanosja duhet të jetë e suksesshme; pra, duhet të çojë në
11 krim. Nuk duhet të jetë vetëm thjesht kanosje, nuk duhet jetë
12 vetëm thjesht kërcënim. Sigurisht, domethënë, ju po thoni që
13 kërcënimi duhet të jetë i mjaftueshëm që personi i kërcënuar
14 të përmbahet nga dhënia e deklaratës që do të kishte dhënë
15 ndryshe.

16 Z. REES: [Përkthim] Po. Ky është interpretimi ynë. Ky
17 është parashtrimi ynë. Ne jemi mbështetur si më poshtë për
18 këtë pozicion tonin.

19 Së pari, Trupi Gjykses edhe pse e ka rrëzuar
20 parashtrimin, Prokuroria duhet që të provonte secilën prej
21 këtyre tre pasojave, megjithatë Trupi Gjykses tha që pasoja e
22 ndaluar nuk ishte vetë bërja e kërcënimit në vetvete. Kjo nuk
23 është se ishte pasoja e ndaluar. Pасoja e ndaluar ishte që
24 dikush të mos jepte një dëshmi dëshmitari që ju besonit që
25 ishte e vërtetë ose që të bënte një deklaratë të rreme ose që

1 të mos jepete informacion të saktë për policinë.

2 Dhe kjo ishte pasoja, u tha të paktën, kur u shikua
3 elementi i pasojës dhe, pra, parashtrimi i pasojës eventuale
4 sipas Prokurorisë ishte i mjaftueshëm. Në qoftë se doni mund
5 t'i referohemi edhe dokumenteve me shkrim.

6 Megjithatë, u njoh vetë se pasoja e ndaluar ishte
7 deklarata e rreme ose mosdhënia e deklaratës ose dikush që të
8 mos nxirrte ose të fshihte fakte të qenësishme.

9 Jo vetëm u tha kjo gjë sepse ka edhe shumë nene të tjera
10 të cilat kanë të bëjnë me kanosjen sipas nenit të Kodit Penal
11 të Kosovës, domethënë, sa i takon këtij elementi kjo është e
12 parashikuar si vepër penale edhe në nene të tjera të Kodit
13 Penal të Kosovës.

14 Megjithatë, në nenin 386, Trupi Gjykues dhe Gjykatësi i
15 Procedurës Paraprake ishte i mendimit që duhet që të provohet
16 pasoja; kjo do të thotë që kryesi të pengojë dëshmitarin ose
17 personin X që t'i japë një dëshmi, të japë dëshmi të saktë apo
18 të japë informacion të saktë.

19 Kështu që jemi dakord, besoj, të gjithë që sa i takon
20 386, në qoftë se ti përdor detyrimin - në qoftë se përdorë
21 shtrëngimin ose forcën - ndaj një personi i cili është i
22 përfshirë në një procedurë penale me synimin që ky person të
23 japë një deklaratë të rreme, pavarësisht që personi nuk e ka
24 dhënë deklaratën e rreme, atëherë Trupi Gjykues, Prokuroria,
25 Gjykatësi i Procedurës Paraprake të gjithë ishin dakord që kjo

1 nuk ishte vepër penale sipas nenit 386. Dhe nuk është habi
2 kjo, sepse ka vende të tjera në Kodin Penal të Kosovës që e
3 parashikojnë këtë. Për shembull, neni 181 e parashikon
4 kërcënimin ose kanosjen si vepër penale.

5 Pra, ne parashtrojmë që në nenin 387, ashtu siç edhe neni
6 386, kërkon që personi të jetë nxitur. Pra, kryesi të ketë
7 vepruar në mënyrë të tillë që të ketë nxitur personin me
8 qëllime që i përmendëm më sipër dhe personi nga ana tjetër të
9 jetë ndikuar ose të jetë nxitur nga akti i kryesit. Neni 386,
10 siç e ka përcaktuar dhe Trupi Gjykses, është që të mbrojë
11 informacionin e dëshmitarëve dhe, gjithashtu edhe integritetin
12 e procedurave penale ose autorëve të krimeve dhe kryesve nga
13 nxitja e kryerjes së një akti që çon në pengimin e provave.

14 Kështu që nuk ka fare dallim ndërmjet qëllimit të të dy
15 aspekteve. Kështu që, për këtë arsye, ne parashtrojmë, që neni
16 386 është i kufizuar tek përdorimi konkret i forcës, i
17 detyrimit ose kanosjes së rëndë, në qoftë se dëshmitari ka
18 informacion për sa i takon veprës së ndalimit ose pengimit të
19 procedurave gjyqësore që përcaktohen në nenin 386.

20 Në qoftë se, për shembull, duhet t'i referohemi veprës së
21 shpërfilljes së Gjykatës sipas TPNJ-së dhe Gjykatës për Krimet
22 Penale dhe në qoftë se do t'i referohemi gjithashtu edhe
23 Statutit të Romës. Rregullorja 77(A)Pika 4 e Rregullores së
24 TPNJ-së dhe sa i takon edhe dispozitave të tjera, pra, të
25 mekanizmave ndërkombëtarë.

1 Pra, këto janë vepra të cilat janë të përcaktuara në të
2 gjitha këto dokumente, domethënë, janë hartuar shumë ndryshëm,
3 nuk është se kanë fare analogji me nenin 386 të Kodit Penal të
4 Kosovës, megjithatë këto vepra penale në Statutin e Romës dhe
5 në Rregulloren e TPNJ-së nuk thonë as drejtpërsëdrejti dhe as
6 nuk nënkuptojnë pasojën e ndaluar. Megjithatë, kjo është e
7 parashikuar ose është e pranishme në nenin 376.

8 Në rastin, në çështjen Bemba, të cilën e kemi besoj dhe
9 mund ta shfaqim në ekran. Përpiqemi ta gjejmë.

10 Çdo gjë është në prezantim po ka shumë faqe që duhen
11 nxjerrë në fakt. Të gjitha janë dërguar paraprakisht.

12 Le të shohim 737 të Bembës, që është neni 70(1)(c) i
13 Statutit të Romës. Dhoma e Apelit kujton se në çështjen Bemba
14 u gjet fajtor sipas nenit 70(1)(c) dhe nuk kërkoi provën e
15 sjelljes që të kishte pasur vërtet efekt te dëshmitari. Dhe
16 ranë dakord me këto gjetjet, që u mbështetën nga formulimi i
17 kësaj dispozite në vetvete, duke parashikuar se kjo kishte një
18 farë ngjyrimi në veprën penale dhe asgjë më shumë neni
19 70(1)(c) i Statutit e vendos theksin në sjelljen kriminale, në
20 veprimin kriminal.

21 Tani neni 387 shkon dhe mëtej. I referohet rezultatit të
22 kësaj veprimtarie dhe specifikisht përcakton qëllimin apo jo
23 që personi nxitet të përmbahet nga dhënia e deklaratës dhe jep
24 deklaratë të rreme apo mosdhënien e informacionit të policisë,
25 prokurorisë apo gjyqtarit.

1 Pra, thamë cilido qoftë qëndrimi i rregullores së TPNJ-së
2 apo Statutit të Romës, kodi penal i Kosovës që duhet mbajtur
3 parasysh është një instrument që nuk është produkt i Dhomave
4 të Specializuara të Kosovës. Por ka një qëllim edhe më të
5 gjerë sesa rregullorja apo një statut apo një instrument për
6 një Gjykatë Ndërkombëtare.

7 Sepse Kodi Penal i Kosovës ka një qasje ndryshe. Cilado
8 qoftë arsyeja për këtë, e vërteta është se ka një qasje
9 tjetër. Edhe flasim këtu për veprën penale të mosbindjes që
10 është po ashtu parashikuar në rregulloren e TPNJ-së dhe
11 Statutin e Romës.

12 Trupi Gjykses nuk konstatoi dhe nuk kishte si të
13 konstatonte që u nxit në fakt me ndonjë person që të mos bënte
14 deklaratë, të bënte deklaratë të rreme apo të mos i jepte
15 informacion policisë, prokurorisë apo gjyqtarëve. Pra në këtë
16 rast kemi vetëm Dhomat e Specializuara apo ZPS-në. Dhe në fakt
17 do t'i referohem më vonë kësaj kur të flasim për dënimin. Ata
18 dolën pikërisht me vendim të kundërt se nuk pati në të vërtetë
19 ndonjë pengim konkret, nuk pati pengesë. Sa i takon hetimit të
20 ZPS-së si rezultat i veprimit të sjelljes së të akuzuarit.

21 Individualisht por edhe në mënyrë kumulative, këto
22 argumente synojnë *actus reus* të nenit 387 dhe tregojnë se në
23 të vërtetë nuk u përcaktua as me prova as sipas analizës së
24 Trupit Gjykses që qëndron në fakt dhe pika 3 duhet prapësuar.

25 Dhe i referohem faktit se Trupi Gjykses kur doli me, pra

1 kur shqyrtuan pikën 3 dhe vlerësuan faktet edhe bënë analizën
2 e ligjit shpërfillën cilësimin në tërësinë e vet, sa i takon
3 informacionit për pengimin e procedurave penale. Dhe thanë se
4 mjafton në qoftë se një person u nxit, është nxitur për të mos
5 dhënë informacion për çdolloj vepre penale, që ndodh në
6 juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Dhe kjo nuk
7 mbështetet në fakt nga formulimi i vetë nenit 387. Dhe sikurse
8 ju thashë, kam përdorur fjalën "provë" dhe "informacion" në
9 mënyrë të shkëmbyeshme.

10 Tani sa i takon përcaktimit të *actus reus*, gjithashtu
11 përdorën provat e dëshmitares Zdenka Pumper, sa i takon
12 analizës së saj së përmbajtjes së tre paketave. Besoj se kjo
13 i është referuar një herë tre paketa, një herë tre grupe.
14 Besoj ju e kuptoni pse.

15 Ju e dini që përmbajtja e plotë e këtyre paketave nuk u
16 nxor asnjëherë. Sa i takon paketës 2, u nxor një pjesë e madhe
17 e materialit, po ZPS-ja e bëri të qartë se materiali që u nxor
18 nga paketa 2 ishte në fakt publik dhe nuk ishte pjesë e
19 çështjes së tyre.

20 Sa i takon materialit që në fakt u tha se ishte materiali
21 që ishte i mbrojtur, pra ishte informacion i mbrojtur dhe nuk
22 duhej zbuluar vetëm një pjesëz - pra një pjesë iu tregua
23 Trupit Gjykues dhe në fakt edhe Mbrojtjes e njëjta gjë.

24 Dhe e them këtë provë në veçanti kur po kritikoj pranimin
25 dhe mbështetjen në provat e znj. Pumper sa i takon numrit të

1 dëshmitarëve apo dëshmitarëve të mundshëm që thuhet se janë
2 evidentuar në një material që nuk iu tregua asnjëherë Trupit
3 Gjykues apo Mbrojtjes. Është e qartë se këto numra, këto
4 shifra pra, përbënin një pjesë të rëndësishme të vendimit të
5 Trupit Gjykues, pra që kishte *actus reus*.

6 Iu referuan objektit apo fushëveprimit të zbulimit dhe
7 ajo që thanë dhe titulli që përdorën kur vlerësuan *actus reus*
8 të pikës 3. Dhe kjo ishte lidhur me - po e gjej paragrafin e
9 duhur nëse do mundem. Pra "Objekti i zbulimit" që është në
10 faqen 193 të aktgjykimit. Dhe për ta përmbledhur në fillim të
11 pasazhit të paragrafit, Trupi Gjykues i referohet - i akuzuari
12 ka zbuluar identitetin dhe të dhënat personale të shumë
13 dëshmitarëve dhe qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të
14 mundshëm. Dhe provat erdhën vetëm nga znj. Pumper. Ajo i ka
15 dhënë provat për këtë.

16 Ndërsa tani provat për këtë konstatim nuk patën kurrfarë
17 burimi. Qartësisht dokumentet që u treguan, pra dokumentet që
18 ia kanë treguar Trupit Gjykues kishin vetëm gjashtë emra - jo
19 në dokumente - katër ishin në dokumente në fakt. Katër emra
20 personash që mund të vlerësonin dhe u pajtuan se mund të
21 referoheshin si dëshmitarë, por dëshmitarë të mundshëm. Nuk po
22 i them emrat por janë katër zyrtarë serbë këta.

23 Dhe dy dëshmitarë të tjerë u identifikuan me emra, një
24 syresh specifikisht ishte si dikush që pati pasoja të rënda.
25 Do ju flas dhe për këtë pak më vonë.

1 Pra kjo ishte dhe një emër tjetër. Nuk do ta them. E keni
2 në dosjen tonë. Sepse përndryshe do të hymë në seancë të
3 mbyllur dhe duhet të mos e bëj këtë gjë, po nuk besoj se është
4 nevoja sepse emrat janë në dosjen tonë.

5 Pra, gjashtë emra gjithsej. Dhe vetëm katër në dokumentet
6 që iu treguan ju. Dhe të gjitha dokumentet që iu treguan ju
7 ishin vetëm pjesëza të atyre që ka thënë znj. Pumper se çfarë
8 ishin pjesë e këtyre materialeve. Tani prova se kishte me
9 qindra dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm doli vetëm nga
10 znj. Pumper. Ishte vetëm pikëpamja e saj, analiza e saj e
11 dokumentit, rishikimi i saj i dokumentit se çfarë përbënte
12 dëshmitarë dhe çfarë përbënte dëshmitarë të mundshëm.

13 Në rrethana kur dokumentet që nxori ajo përfshirë dhe
14 grafikët, tabelat, në të vërtetë nuk thonin fare sesi u bë kjo
15 analizë dhe dolën me qindra dëshmitarë apo dëshmitarë të
16 mundshëm.

17 Ky është një shembull. Dhe po të shohim faqen e parë se
18 çfarë përbënte pra, cilat ishin në tabelat që përgatiti kjo
19 znj. Pumper. Dhe nëse shohim faqen e parë të këtyre tabelave.

20 Nëse shohim P90, ju lutem znj. Sekretare e Gjykatës. Që
21 është faqja e parë e shtojcës 1. Nëse mund ta shohim për një
22 moment.

23 Pra ky ishte formati. Kështu ishin të paraqitura tabelat.
24 Kjo tabela është përgatitur sepse besoj se ishte në fakt
25 Gjykatësi i Procedurës Paraprake që ra dakord se dokumentet në

1 paketat ishin nxjerrë tërësisht në kuptimin që kishin
2 përmbushur kriteret e rregullit 102(3) dhe rregullit 103. Po
3 kjo sepse për shkak të rregullit 108, ai në fakt autorizoi
4 redaktimet, pra ai autorizoi mosnxjerrjen e informacionit që
5 nuk duhej nxjerrë, pra autorizoi mosnxjerrjen.

6 Dhe urdhëroi si masë kompensuese që të mos përdorej si
7 provë - që në fakt ndodhi e kundërta - po si masë kompensuese
8 për të garantuar drejtësi për Mbrojtjen, për arsye se nuk iu
9 nxor dokumenti dhe urdhëroi përgatitjen e këtyre tabelave që
10 duhet të jepnin një ide të llojit të dokumentit - që ishte
11 letër a ishte postë elektronike - dhe bashkëlidhur është dhe
12 lista e dëshmitarëve, titulli i dokumentit, titulli, data,
13 përshkrimi i dokumentit, prejardhja, përpiluesi i dokumentit,
14 indicie që sugjerojnë ndonjë farë natyre konfidenciale, emri i
15 dëshmitarëve të mundshëm.

16 Tani po e lëmë mënjanë masën kompensuese për mosnxjerrjen
17 e materialeve. Por, në thelb ndonëse kjo tabelë kishte një po
18 ose jo, nëse znj. Pumper vetë ishte e mendimit se emri i një
19 dëshmitari apo dëshmitari të mundshëm - kjo ishte sipas
20 pikëpamjes së saj apo standardit të saj. Është përmendur aty
21 thjesht një po ose jo që e ka vendosur ajo. Nuk kemi asnjë
22 kurrfarë shifre, nuk thotë ndonjë informacion nëse në rreshtin
23 një është bërë "po", nuk thotë a ishte dëshmitar apo dëshmitar
24 i mundshëm ky. Në rreshtin 2 po kemi "po", i njëjti emër ama.
25 Është i njëjti emër. Nuk kemi asnjë informacion, asnjë tregues

1 dhe asnjë formë për të vërtetuar apo për t'i vërtetuar apo për
2 t'i kundërshtuar deklaratat e saj, sepse ato ishin analizë e
3 saj, dhe tha qindra dëshmitarë apo dëshmitarë të mundshëm.

4 Tani ne vendosëm, ne kërkuam që të zbatohet dëshmia e
5 znj. Pumper, W04841, në tërësinë e vet. Sa i takon këtij
6 apeli, unë, pra ankesa ime konkretisht me këtë apel është -
7 lidhet me refuzimin për të përjashtuar provat për pjesën që
8 lidhet me përmbajtjen e paketave që as u nxorën dhe as u
9 shfaqën.

10 I jemi referuar me shkrim pjesëve të transkriptit ku
11 ngritëm papranueshmërinë e provave të saj, përmbledhja e
12 dokumenteve që as i janë treguar as i janë nxjerrë Trupit
13 Gjykues, qoftë para gjykimit, qoftë në fillim të dhënies së
14 provave të saj edhe pas si Trupi Gjykues edhe njëherë vendosi
15 ta shtynte çështjen e papranueshmërisë, atëherë ne vendosëm të
16 kërkonim që të shtyheshin e të mos pranoheshin dokumentet e
17 saj, sepse ajo po përshkruante analizën e saj të dokumente.
18 Dhe ajo nuk kishte asnjë lloj marrëdhënie, përveç faktit që i
19 kishte parë dokumentet në kuadër të marrëdhënies së saj të
20 punësimit si hetuese në ZPS.

21 Dhe e kemi përmendur dhe në dosjen e apelit të njëjtën
22 gjë dhe është përmendur, për shembull, kemi dhe raste të
23 ngjashme, Perisiç, Bizimungu, apeli i Millosheviçit - nuk po i
24 përmendim të gjitha referencat sepse janë të gjitha
25 bashkëngjitur dosjes sonë të apelit këto - kur në këto raste,

1 TPNJ-ja dhe ICC-ja e kanë kritikuar përdorimin e raporteve të
2 hetuesve, përmbledhjes së dokumenteve që kanë bërë vetë
3 hetuesit, ku vetë hetuesi apo hetuesja nuk ka marrëdhënie
4 tjetër përveçse i është kërkuar të analizojë apo të bëjë punën
5 e saj në kuadër të marrëdhënies që ka me Prokurorinë.

6 Në çështjen e Perisiç, paragrafi 15, ata thanë që hetuesi
7 u njoh me këto dokumente thjesht sepse u desh t'i shikonte në
8 kuadër të marrëdhënies së punësimit. Pra dhe mund të dëshmojë
9 vetëm si dëshmitar fakti sa i takon kronologjisë të
10 prejardhjes së dokumenteve në kuadër të marrëdhënies të punës
11 që ka.

12 Pra, ishte çështje opinionit, ishte një opinion i znj.
13 Pumper se dokumentet përmbanin identitetin e qindra
14 dëshmitarëve apo dëshmitarëve të mundshëm. Një opinion që nuk
15 e kundërshtojmë dot sepse nuk i kemi parë ndonjëherë këto
16 dokumente. Dhe më e rëndësishme është se Trupi Gjykses vetë,
17 nuk i pa këto dokumente - nuk ia treguan këto dokumente, në
18 mënyrë që t'i vlerësonte vetë dhe të zbatonte standardin e vet
19 sa i takon dëshmitarit apo dëshmitarit të mundshëm për qëllim
20 të pikës 3, sepse ata nuk u pajtuan tërësisht me standardin që
21 përdori znj. Pumper.

22 Dhe në mungesë të përdorimit të këtyre provave,
23 përmbledhja e hetueses dhe pa asnjë lloj kundërshtimi nuk
24 duhet të ishte marrë parasysh, nuk duhet të ishte parë si një
25 vlerësim i pavarur. Sepse nuk është si i atillë. Pra vlera

1 provuese e vlerësimit të saj ishte thjesht vlera provuese e
2 një zeroje - pra nuk ka vlerë provuese, është thjesht puna e
3 një prokuroreje që hap një çështje dhe shpjegon përmbledhjen e
4 saj dhe aty thotë që dokumentet përmbajnë qindra dëshmitarë
5 apo dëshmitarë të mundshëm.

6 Nxjerrja e dokumenteve, nxjerrja e atij materiali nëse
7 Prokuroria do të mbështetej në përmbledhjen e znj. Pumper,
8 përmbledhja e materialit që ajo tha, jo vetëm që do ta kishte
9 bërë çështjen më pak komplekse, por në të vërtetë do ta kishte
10 bërë të drejtë këtë gjyq, këtë gjykim. Dhe në mungesë të
11 nxjerrjes së këtyre dokumenteve, duke mos u nxjerrë këto
12 dokumente, mbështetja në provat e znj. Pumper sa i takon
13 numrit të dëshmitarëve apo dëshmitarëve të mundshëm ishte e
14 padrejtë, ishte e padrejtë të mbështetej në dëshminë e saj.
15 Dhe ky fakt ishte një pjesë e rëndësishme e vlerësimit të
16 Trupit Gjykues për *actus reus* për pikën 3. Pra parashtrimet i
17 keni të plota në dosjen time, kështu që nuk po i lexoj me
18 hollësi në këtë pikë.

19 Por shkurtimisht dua t'i kujtoj Trupit Gjykues në
20 paragrafët 75 deri 95, kemi ngritur pikat, i kemi shtjelluar
21 më tej këto pika domethënë. Fakti se Trupi Gjykues,
22 konstatimet e Trupit Gjykues se frika dhe shqetësimet lidhur
23 me qindra dëshmitarëve apo dëshmitarëve të mundshëm që
24 përmendi znj. Pumper - fakti pra kanë pasur frikë apo
25 shqetësim mund të kenë qenë, pra nuk nënkuptonin në të vërtetë

1 se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve shkaktuan këtë
2 kërcënim apo përbënin kërcënim. Dhe në fakt ka një
3 mospërputhje në vendimin e Trupit Gjykses kur dolëm sa i takon
4 pikës së referimit të çështjes së shkallës së zbulimit dhe
5 konstatimi i tyre se shumë persona u trembën, patën frikë apo
6 shqetësime.

7 Dhe konstatimi në kuadër të pikës 5, se vetëm një
8 dëshmitar në fakt pësoi frikë dhe shqetësime që mund të
9 konsiderohet si një ndërhyrje e konsiderueshme në sigurinë dhe
10 mirëqenien e personit apo familjes së tij. Kjo ishte fraza që
11 përdori Trupi Gjykses për të vlerësuar nëse ka pasur pasoja të
12 rënda që është fraza statutore pra, nëse ka pasur vërtet
13 pasoja të rënda për qëllim të pikës 5. Ata thanë që pati
14 pasoja të rënda sa i takon ndërhyrjes të rëndësishme në
15 sigurinë, mirëqenien, privatësinë, dinjitetin e personave.

16 Shumë persona patën frikë dhe shqetësime bazuar në një
17 analizë që u bë, por në fakt doli që vetëm një dëshmitar,
18 vetëm një dëshmitar ishte në fakt personi që pësoi ndërhyrje
19 të konsiderueshme që e kemi përmendur në paragrafin 538.

20 Po dhe këto konstatime ne i qortojmë. Jemi kritikë ndaj
21 këtij konstatimi. Ky është një person dhe nuk ka pasur asnjë
22 provë prej tij vetë, qoftë personalisht apo në prova dytësore
23 që të tregojë se ka pasur frikë apo ka pësuar frikë apo
24 shqetësime. Mbi të gjitha, ky person është një person i cili
25 për shumë vite, të paktën që nga 2012 ka qenë vetë shumë

1 person publik, ka folur publikisht për bashkëpunimet me
2 hetimin për shkeljet e mundshme që mund të kenë kryer anëtarët
3 e UÇK-së, ka folur me shtypin, ka dhënë intervista. E ka bërë
4 të qartë se ai nuk kishte fare frikë, kurrfarë shqetësimi
5 s'kishte ky person në qoftë se i bëhej publik emri. Dhe kjo
6 është e dukshme nga veprimtaria e tij publike.

7 Pra një dëshmitar u konstatua se kishte pësuar frikë dhe
8 shqetësime që mund të konsiderohen thelbësore edhe të cilit i
9 është cenuar mirëqenia, dinjiteti, siguria. Por sa i takon
10 këtij personi nuk morëm parasysh faktin që thatë që ai person
11 s'pati asnjë frikë apo shqetësim. Por në fakt u mbështetën në
12 një shënim, ku ai vetë asnjëherë s'e ka përmendur këtë frikë
13 apo këtë shqetësim konkret.

14 Ju i keni parashtrimet për pikën 1(1)(b) dhe për fjalën
15 "kanosje serioze" në kuadër të nenit 387, që kufizohet me
16 përdorimin e fjalës forcë. Fjalët menjëherë paraprihen nga
17 fjalët "përdorimi i forcës" që në fakt pastaj janë në
18 kontekstin e fjalës "kanosje serioze" që është përdorimi i
19 forcës apo kanosje serioze.

20 Nuk do ta përmend dosjen, por dua të shtjelloj një pikë.
21 Ju duhet t'ju kujtohet që Trupi Gjykses përmendi dhe shembuj
22 të tjerë, mori dhe shembuj të tjerë të Kodit Penal të Kosovës,
23 kur ishte përdorur kanosja si pjesë të veprave të tjera
24 alternative penale. Dhe në fakt thamë, kur i sheh këto vepra
25 penale, ka një pikë të përbashkët në gjithë këto shembuj me

1 përjashtim të veprës penale të dhunës seksuale, për të cilën
2 do të flas më vonë. Por, të gjithë shembujt e tjerë flasin për
3 kanosjen për të dëmtuar personin apo vlerën pasurore, pra
4 sidomos personin dhe vlerën pasurore, pronën. Pa hyrë në
5 hollësi, ne i kemi renditur ato në dosjen tonë. Në fakt i
6 referohemi specifikisht nenit 181 sepse kjo është vepra penale
7 e kanosjes. Tani, neni 181 e bën të qartë se fjalët "kanosje
8 serioze" lidhen me vepra, fjalë, vepra, apo gjeste, që i
9 shkakton ndonjë gjë të keqe një personi tjetër. Pra kjo është
10 kanosja serioze, ku përveçse është evidentuar specifikisht siç
11 e kemi në rastin e sulmit seksual apo dhunës seksuale, pra
12 kanosja për të dëmtuar reputacionin dhe nderin e një personi.

13 Përndryshe, kanosja gjithandej lidhet ose me kanosjen
14 ndaj personit apo ndaj pronës. Dhe konkretisht neni 181 që
15 është vetë kanosja, kanosja serioze. Pra të kanosësh
16 seriozisht personin lidhet me fjalë, vepra apo gjeste. Pra,
17 kur themi dëm personi, nënkupton dëm fizik të një personi.
18 Neni 181 është po ashtu një vepër penale, përmban një vepër
19 penale në kapitullin, në kreun XVII [sipas përkthimit] të
20 kodit penal, ku është "Vepra penale kundër jetës dhe trupit".

21 Kanosje serioze, për qëllim të nenit 181 dhe ne këtu po
22 flasim për nenin 387, që tani nënkupton kërcënim ndaj jetës
23 dhe trupit.

24 Në këtë çështje Trupi Gjykues nuk konstatoi ndonjë
25 kanosje serioze, nuk konstatoi të kishte pasur ndonjë kanosje

1 serioze. Dhe interpretimi i gjerë i fushëveprimit të kanosjes
2 do të thotë që dikush nuk mund të thotë, nuk mund të kuptojë
3 që kanosja që konstatuan lidhet me kanosjen e përdorimit të
4 forcës ose dëmtimin apo dëmtimin serioz për një person. Në
5 këto rrethana, po e them edhe njëherë *actus reus* i nenit 387
6 nuk është përcaktuar.

7 Tani para se ta mbyll me pikën 3, unë e trajtova çështjen
8 e cilësimit të nenit 387 që vlen për të tre alternativat e
9 shprehura aty. Sigurisht kjo lidhet edhe me synimin, dashjen
10 pra. Ne themi se për hir të nenit, për qëllim të nenit 387 një
11 person vlen me dashje direkt dhe është në dijeni kur përdor
12 kanosje serioze për të nxitur një person të përmbahet nga
13 dhënia e deklaratave, të bëjë deklaratë të rreme apo
14 mosdhënien e informacionit të vërtetë organeve policore,
15 prokurorit apo gjyqtarit për vepra që lidhen me pengimin e
16 procedurës penale dhe e dëshiron kryerjen e kësaj vepre
17 penale.

18 Tani sikurse konstatoi Trupi Gjykses nuk mjafton vetëm
19 dashja e personit për të shkurajuar një person që të mos i
20 japë prova Dhomave të Specializuara. Ky nuk mjafton për të
21 përkufizuar si dashje. Kjo dashje në vetvete mund të jetë
22 krejt legjitime, mund të përdorin forma legjitime për të
23 bindur dikë - qoftë edhe përmes një bisede - i thonë mos jep
24 prova. Po kjo nuk mjafton.

25 Askund në aktgjykim nuk ka konstatuar Trupi Gjykses që i

1 akuzuari ishte në dijeni për veprimtaritë e tij, deklaratat e
2 tij të përbënin kanosje serioze. Dhe nuk kanë bërë asnjë lloj
3 përfaqësimi - ku janë rastet që nënkuptohet se ka pasur
4 dëmtim. Edhe as i akuzuari nuk dëshiroi - që të vërtetonin që
5 i akuzuari vërtet dëshironte që veprimet dhe deklaratat e tyre
6 të përbënin kërcënim për të dëmtuar një person tjetër. Thjesht
7 nuk dolën, nuk e gjetën diçka të tillë.

8 Dhe as nuk konstatuan që ata ndërvepruan në një mënyrë të
9 tillë apo dëshironin të nxisnin një person që specifikisht të
10 përmbahej nga bërja e një deklarate, dhënia e deklaratës së
11 rreme apo mosdhënia e informacionit. E shpërfillën dashjen,
12 pra *mens rea*. Sërish, fjala "e vërtetë" në alternativën, në
13 cilësimin e alternativës së tretë nëse në të vërtetë po
14 vepronte me dashje kishte dëshirë të nxiste një person që të
15 përmbahej nga dhënia e informacionit të vërtetë. Nuk e kanë
16 marrë parasysh këtë gjë. Po ashtu kjo vlen, pra e njëjta gjë,
17 a donte të ndërhynte për të ndikuar tek personat për të mos i
18 dhënë informacion ZPS-së. Po ashtu shpërfillën cilësuesin se
19 informacioni duhet lidhur me pengimin e procedurave penale kur
20 morëm parasysh *mens rea*, veprimin e fajshëm pra.

21 Edhe njëherë, *mens rea* veprimi me dashje, dashja
22 indirekte nuk u përcaktua.

23 Dhe së fundi, kemi thënë për pikën 3 se ndonëse Trupi
24 Gjykues konstatoi dashje direkte, ne e kundërshtuam dhe ata
25 ranë dakord me kundërshtimin tonë. Ne thamë se konstatimi i

1 Trupit Gjykues se dashja eventuale nuk ishte e mjaftueshme si
2 alternativë.

3 Dhe ne jemi dakord me mendimin e Gjykatësit Barthe, që
4 është efekti ose fjala "të nxisësh", në nenin 387 tregon
5 specifikisht qëllim objektiv, aktivitet që ka një qëllim të
6 caktuar. Pra, qëllimi për të nxitur me dashje personin të
7 përmbahet nga dhënia e një deklaratë dhe kështu me radhë.

8 Ne e themi ndryshe. Ne konstatojmë, vërejmë se në lidhje
9 me pikat e tjera 1, 2, 5, 6, Trupi Gjykues në pjesën 3 të
10 aktgjykimit përcaktoi me saktësi atë që thanë që kërkonte
11 ndërgjegjësimin, vetëdijen dhe pasojat e ndaluara të synimit.
12 Për qëllimet e pikës 3, si pjesë e pjesës 3, ata nuk e
13 përcaktuan asnjëherë qartë që kjo që thanë kërkohet përmes
14 synimit eventual.

15 Në fakt thanë, në paragrafin 121, se:

16 "...faza për 'të nxitur' tregon ose dëshirën e kryesit
17 si në bazë të nenit 21(2)... apo pasojën e ndaluar të pranuar
18 të veprimit të tij..."

19 Dhe thonë që pasoja e ndaluar ishte që dikush të
20 përmbahet nga dhënia e një deklaratë të rremë. Që në të
21 njëjtën kohë, ata tregonin se neni 387 nuk kërkoi asnjëherë
22 provë të ndonjë pasoje.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] A mund t'ju
24 ndërpres?

25 Z. REES: [Përkthim] E di orën.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mbase dhe
2 15 minuta më shumë, por jo më tepër.

3 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] A mund t'ju bëj një pyetje
4 tjetër?

5 Në nenin 387, interpretimi tuaj i "kërcënimit të rëndë"
6 do të thotë kërcënim i përdorimi të forcës. Si lidhet kjo me
7 pjesën tjetër, çdo mjet tjetër të detyrimit? Si u lejuan
8 hartuesit në rastin e një kërcënim më të vogël apo të
9 detyrimit kur për më lart kërkojnë kërcënimin e forcës?

10 Z. REES: [Përkthim] Pajtohem me ju. Mund të kishin thënë
11 "përdorimi i çdo mjeti detyrues". Nuk e bënë këtë, por
12 shprehimisht përdorën përdorimit të forcës apo kërcënim të
13 rëndë apo çdo mjet tjetër.

14 Për shembull, konstatimi i Trupit Gjykses se kërcënim
15 ndaj privatësisë apo dinjitetit - siç e kanë thënë - të
16 personave të mbrojtur, dëmtimit të këtyre të drejtave, ato
17 mund të futen në fushëveprimin e çdo mjeti detyrues. Unë e
18 kuptoj këtë. E kam përmendur dhe në dosje. Por Trupi Gjykses
19 nuk konstatoi apo nuk mori parasysh në fakt mjete të tjera
20 detyruese. Konkretisht thanë që nuk i kanë marrë parasysh.
21 Përmendin Prokurorinë që e bën të qartë, për shembull po të
22 gjej referencën nëse mundem. Trupi Gjykses nuk mori parasysh
23 ndonjë mjet tjetër detyrimi as element alternativ. Ata thanë,
24 paragrafi 557, se:

25 "ZPS-ja nuk thotë që i akuzuari ka përdorur forcë apo

1 mjete të tjera detyrimi, premtimin e një dhurate apo përfitime
2 të tjera, prandaj nuk do të trajtohet kjo pjesë, kjo formë.”

3 Pra, Trupi Gjykses e pranoi se po ndiqte një qasje të
4 drejtë në lidhje me z. Gucati, i cili nuk duhej vlerësuar duke
5 iu referuar mjetit që ZPS-ja nuk e paraqiti në këtë dritë. Dhe
6 se duhej vlerësuar në bazë tjetër.

7 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Është një argument
8 procedural. Nuk ka të bëjë me interpretimin e drejtë të nenit
9 387. Është një çështje themelore. Përse hartuesi ka lejuar
10 forma të tjera detyrimi, në këtë rast duhet kërcënuar, duhet
11 ngushtuar objekti i kërcënimit, kërcënim, përdorim force.

12 Z. REES: [Përkthim] Në përgjigje të pyetjes suaj, Rees, e
13 kuptoj, sepse po ta mendosh sesi duhej hartuar mund të thuhej,
14 “çdo mjet detyrimi, çdo mjet detyrimi, për shembull, i
15 përdorur për të nxitur një person për të mos dhënë një
16 deklaratë” apo të tjera. Nuk e bënë. Konkretisht i referohet
17 përdorimit të forcës dhe konkretisht përdorimit të kërcënimit
18 të rëndë, të cilët futen në mjetet e tjera të detyrimit, të
19 cilët përcaktohen si të ndryshme nga përdorimi i forcës dhe
20 përdorimi i kërcënimit të rëndë.

21 Dhe ne themi që kërcënimi i rëndë kuptohet duke iu
22 referuar fjalëve “përdorimit të forcës” dhe në bazë të nenit
23 181, ku përcaktohet vepra e kërcënimit që bëhet e qartë që
24 kërcënimi i rëndë i referohet kërcënimit ndaj jetës dhe trupit
25 të një personi.

1 Dhe tani duke pasur parasysh orën që po ikën, të kalojmë
2 tek apelimi i dënimit.

3 Ne themi se Trupi Gjykses bëri gabime të dukshme në
4 dënimin e z. Gucati, kur vlerësoi seriozitetin apo peshën e
5 rëndë të veprës së tij dhe këto i kemi paraqitur në pikën 81
6 të njoftimit. Nuk përdori forcë apo kërcënim. Nuk dëshironte
7 që t'i shkaktohej dëm ndonjë njeriu. Nuk synonte të pengonte
8 dhe kemi dhënë referenca të njoftimit tonë kur Trupi Gjykses i
9 gjeti këto tipare. Se nuk u shkaktua asnjë dëm hetimeve të
10 Prokurorisë. Dhe siç thashë ndërkohë vetëm një numër i
11 kufizuar personash mund të jenë konstatuar se kanë pësuar dëm
12 dhe askush prej tyre në fakt nuk ka pësuar ndonjë dëm ndaj
13 personit të tyre.

14 Fakti që Trupi Gjykses vendosi që kërcënimi i rëndë nuk
15 kufizohet me kërcënimin e forcës, kjo do të thotë që ato kanë
16 konstatuar se ka pasur kërcënim të rëndë dhe ne e
17 kundërshtojmë këtë gjë.

18 Synimi më i lartë sipas Trupit Gjykses në paragrafin 543
19 dhe 596, është se ai nuk mori parasysh që mund të ndodhte
20 ndonjë dëmtim. Ai nuk dëshironte sipas gjetjeve të tyre që të
21 shkaktojnë ndonjë dëm konkret.

22 Ai konstatoi në paragrafin 499, këto që vijojnë: Veprimi
23 i të akuzuarit i nxjerrjes së informacionit të mbrojtur,
24 sidomos medias profesionale nuk ndikoi në konstatimin e
25 nxjerrjes së informacionit të mbrojtur.

1 Këtë që do dua të them janë këto: Ata, aty konstatuan se
2 z. Gucati i nxori kryesisht medias, vetëm medias profesionale.
3 Kjo masë ishte një masë që e ulte rrezikun dhe duhej të ishte
4 pasqyruar edhe në dënimin e tyre. Ishte një veçori që e
5 konstatuan, por që nuk e morën parasysh për qëllimet e
6 dënimit.

7 Ata vunë në dukje se z. Gucati nuk kërcënoi asnjë nga
8 zyrtarët e ZPS-së edhe pse nuk e pranuan në konstatimin e tyre
9 kur morën vendim që nuk kishte synim të kërcënonte njëri. Ajo
10 që ka rëndësi ishte se ata nuk morën masa për të trajtuar
11 pasojat që rezultuan nga sjellja e z. Gucati, që të cilës i
12 duhej dhënë një peshë kur është vlerësuar pesha e rëndesës.

13 Asnjë person nuk u gjet se ka nxitur njeri apo për të mos
14 dhënë informacion apo kanë dhënë informacion të rremë.

15 Trupi Gjykses tha se mori parasysh se ZPS-ja në fund të
16 fundit nuk provoi se u pengua në aftësinë për të kryer hetime.
17 Se në fakt ata konstatuan se kishte synim por jo pengim
18 konkret. Dhe ne themi, po të kthehemi pak mbrapa dhe të
19 shikojmë dënimin katër vjet e gjysmë, ata i dhanë peshë të
20 pamjaftueshme këtij faktori. E themi këtë sepse dëmi është
21 treguesi kryesor i rëndesës së një vepre dhe mungesa e një
22 dëmi në këtë rast duhet t'i ishte dhënë peshë më të madhe në
23 dënimin prej katër vjet e gjysmë që ne mendojmë që është
24 proporcioni i paarsyeshëm në gamën e dënimeve të dhëna nga
25 gjykata ndërkombëtare në të kaluarën për vepra të ngjashme dhe

1 kjo ishte në përputhje me konstatimin e tyre që ata nuk i
2 shkaktuan ndonjë dëm hetimeve.

3 Ne kemi hollësi të mëtejshme në dosjen tonë me shkrim
4 sesi provat e përmendura për shembull, në 7 shtator 2020 kur u
5 mbajt konferenca e parë dhe në 16 shtator kur u mbajt
6 konferenca e dytë, z. Jukiç, dëshmitari, pra e pranoi se
7 asnjëra prej këtyre gjërave nuk shkaktoi ndonjë kërcënim për
8 sigurinë e personave. Në bazë të konferencave nuk u desh të
9 merrnin ndonjë masë.

10 Nuk u gjet që të kishte pasur persona që të kishin pësuar
11 shumë dëmtime. Një person u përmend se paska pasur frikë dhe
12 shqetësime që ishin baras me një ndërhyrje të rëndë.

13 Trupi Gjykues gjeti dy persona që u zhvendosën. Ne e
14 kritikojmë këtë konstatim, duhet ta dini. I keni të gjitha me
15 dosjen me shkrim. Pra në maksimum ishin dy persona që u
16 zhvendosën.

17 Dhe pastaj u paraqit provë se gjithsej 20 deri 30 persona
18 iu nënshtruan masave të tjera të sigurisë. Kjo ishte shifra më
19 e madhe e përgjithshme. Brenda kësaj shifre, disa prej tyre iu
20 nënshtruan vlerësimit të rrezikut sipas ZPS-së. Por Trupi
21 Gjykues nuk dëgjoji ndonjë provë tjetër, vetëm se 20-30 persona
22 iu nënshtruan kësaj. Në këtë shifër, 20-30, disa persona iu
23 dhanë numra të rinj telefoni apo komunikime, mjete të tjera
24 komunikuese që nuk ishin baras me një ndërhyrje të rëndë.

25 Për sa i takon këtij numri që është më pak se 30. Ne nuk

1 e dimë sesa është. Rreziku u quajt nën nivelin më të madh, më
2 të lartë sepse këtë e vuri në dukje dhe dëshmitari Jukiç dhe e
3 keni atë referencën e transkriptit të dëshmisë të tij dhe ne e
4 dimë edhe nga përgjigje të tjera lidhur me riskun apo rrezikun
5 që u vlerësua si më i ulët.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] A mund të
7 përfundoni?

8 Z. REES: [Përkthim] Gama e dënimit për ne, për mendimin
9 tonë, duke pasur parasysh praktikat e tribunalëve
10 ndërkombëtarë që kanë kryer vlerësime në lidhje me vepra të
11 përbuzjes së gjykatës apo të frikësimit, e përcaktojnë qartë
12 gamën e dënimeve. Kjo gamë shkon në bazë të rasteve të tjera,
13 përfshin një gjobë deri në një dënim prej 18 muajve deri në dy
14 vjet, që është më e larta në këtë gamë dënimesh.

15 Dhe në dosjen tonë ne kemi përmendur përmbledhje të gamës
16 të këtyre që ka dhënë dhe Gjykatësi Orië. Në krye ka qenë një
17 dënim prej dy vitesh në çështjen Sheshelj.

18 Kemi dhënë një përmbledhje të rasteve përkatëse që e
19 mbështesin këtë gamë dënimesh. Brenda këtyre çështjeve ka disa
20 veçori rënduese që janë paraqitur, kontakti i drejtpërdrejtë
21 me dëshmitarët, kontakte botimi i të dhënave të tyre, personat
22 që kanë pësuar dëm të drejtpërdrejtë, për shembull humbjen e
23 biznesit apo viktimat e nxitur për të kryer një vepër dhe
24 pastaj më pas është dënuar për atë. Abuzimi i besimit, një
25 tipar tjetër i rëndë. Ndërhyrje në dëshmitarë të cënueshëm por

1 shumë të rëndësishëm. Personi i nxitur për të mos dhënë
2 deklarata apo për të dhënë një deklaratë të rreme apo për të
3 mbajtur informacion apo kryerje veprash për një kohë të gjatë,
4 në çështjen Sheshelj, për shembull, ku është dënuar
5 vazhdimisht për vepra apo planifikim të sofistikuar. Pra
6 sofistikimi i vërtetë në rastin e Rasiç, Gombo, Ngirapatware.
7 Të gjitha tipare të cilat në fakt mungojnë në çështjen
8 aktuale.

9 Nuk sugjeroj se këto janë të barabarta lidhur me çështjen
10 e Gucatit. Sigurisht janë të ndryshme, gjithmonë kanë
11 ndryshime. Po ideja është që ka raste që janë të ngjashme me
12 raste të tjera. Sigurisht që ka dallime. Por ne parashtrojmë
13 se tribunali duhet të kërkojë çështje të ngjashme përpara se
14 Gjykata merr një farë ndihme nga këto raste të tjera, kur
15 mungojnë rrethana identike.

16 Gjykata duhet të marrë parasysh skenarë të ndryshëm,
17 dallime dhe të shohë se ku qëndrojnë këto fakte në këtë
18 çështje krahasuar me raste të tjera.

19 Ka dhe një rast tjetër, përpara se të përfundoj. Është
20 çështja Margetiç, referenca është IT-91-77.6 [sipas
21 përkthimit]. Nuk e paraqesim dot në ekran.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Nuk më
23 kujtohen të gjitha çështjet, por e keni përmendur.

24 Z. REES: [Përkthim] Jo, kjo Margetiç, nuk e kam përmendur
25 në dosjen e Mbrojtjes. Nuk është aty, po doja ta shtoja. Është

1 një çështje e TPNJ-së e vitit 2007.

2 Është një çështje ku një gazetar ka botuar online listën
3 e plotë të dëshmitarëve të mbrojtur në një çështje. Ishin nja
4 njëqind dëshmitarë, më shumë se njëqind dëshmitarë. Në atë
5 çështje, mesa mbaj mend dënimi ishte tre muaj gjithsej dhe
6 gjobë dhjetë mijë euro.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z. Rees, do
8 ta gjejmë.

9 Z. REES: [Përkthim] Do ta gjeni.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Tani që
11 kemi referencën, e gjejmë vetë.

12 PËRKTHYESJA: Mezi dëgjohet se është larg mikrofonit. Nuk
13 e dëgjoj dot. Boton të gjithë listën e dëshmitarëve.

14 Z. REES: [Përkthim] E gjithë lista e dëshmitarëve u
15 botua. Numri i përgjithshëm ishte, mendoj, 102 dëshmitarë. Dhe
16 kjo erdhi mbas paralajmërimeve lidhur me sjelljet e mëparshme
17 dhe provat konkrete të cilat nuk u kundërshtuan se patën efekt
18 material, të paktën në lidhje me tre dëshmitarë, për shëndetin
19 e tyre dhe për bashkëpunimin e tyre me hetimin. Pra, prova
20 është që janë penguar hetimet.

21 Pra, u kërkoi që ta keni parasysh lidhur me gamën e
22 dënimit.

23 Pra, sigurisht e pranojmë që ka ndryshime, dallime midis
24 këtyre çështjeve, çështjes së z. Gucati. Por megjithatë, të
25 japësh një vendim dënimi për katër vjet e gjysmë që është në

1 fakt dyfish i dënimit më të lartë të parashikuar nga gjykatat
2 e tjera që përmenda, që ishte 18 muaj deri në 2 vjet. Në këtë
3 rast, nuk ka - kjo çështja e z. Gucati nuk ka tipare të
4 ngjashme me çështjet që përmenda unë, siç është rasti i
5 botimit të listës së dëshmitarëve. Nuk ka ndonjë provë që
6 persona janë dëmtuar, besimi është cenuar e kështu me radhë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Do t'i
8 lexojmë.

9 Z. REES: [Përkthim] Pra, të japësh vendim dyfish, dy herë
10 më shumë nga dënimi i përmendur më përpara është i tepruar në
11 rrethanat.

12 Dhe ne kërkojmë nga ju të nderuar, që të kini parasysh të
13 gjitha pikat që i nënshtrohen 20 arsyeve të apelit në
14 njoftimin tonë paraprak; dhe në të kundërtën ta reduktoni, ta
15 ulni dënimin në bazë të këtyre provave. Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
17 Faleminderit, z. Rees.

18 Tani do të bëjmë një pushim për disa minuta. Do të
19 fillojmë përsëri në 3.45 minuta.

20 ZNJ. BERNABEU: [Përkthim] Z. Cadman dëshiron që të flasë
21 mbas pushimit, nëse është e mundur.

22 Z. Cadman do ta mbajë vetë fjalën nga larg, në qoftë se
23 është e mundur.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në rregull.

25 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës

1 këshillohen]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z. Cadman,
3 dëshironi t'i shtoni gjë fjalëve që tha bashkëmbrojtësja.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] E ngrita më
5 herët dorën. E vlerësoj pyetjen tuaj. Nuk ndihem mirë me
6 shëndet. Por do të bëj më të mirën time që të paraqesim fjalën
7 tonë. Nëse do të lindë nevoja do t'i kërkoj ndonjërit prej
8 kolegëve të vazhdojë.

9 Në qoftë se do të kemi nevojë të futemi në seancë private
10 - shpresoj që jo - po nëse është, sigurisht do ta marrë fjalën
11 kolegia, znj. Bernabeau.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
13 Faleminderit. Jemi mirënjohës që pranuat ta ndiqni seancën nga
14 larg.

15 Tani bëjmë pushim deri në 3.45.

16 --- Pauza fillon në orën 15.26

17 --- Seanca rifillon në orën 15.46

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Tani
19 vazhdojmë me parashtrimet e Mbrojtjes së z. Haradinaj.

20 Z. Cadman, fjala për ju.

21 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit,
22 e nderuar Gjykatëse.

23 Së pari, më lejoni t'ju falënderoj që më dhatë mundësinë
24 që të bëj parashtrimet e mia me video lidhje. Nuk është
25 situata ideale, nuk është situata që do të kisha shpresuar. Në

1 fakt është hera e dytë gjatë procedurës gjyqësore që jam
2 infektuar me Covid. Ju kërkoj ndjesë. Në këto rrethana kjo
3 ishte e vetmja gjë që mund të bëja. Edhe njëherë më lejoni
4 t'ju them që e vlerësoj shumë që më dhatë mundësinë që të
5 flisja. Së pari, faleminderit që na dhatë shpjegimin dhe
6 urdhrin tuaj me gojë, sa i takon vendimit për të mos u shtyrë
7 më procedura gjyqësore dhe faleminderit që më dhatë mundësinë
8 që të bëj parashtrimet në emër të klientit tim sot.

9 Sikurse e thashë edhe përpara pushimit, në qoftë se për
10 arsye të ndryshme do ta ndjej veten të dobët, do t'ia jap
11 fjalën koleges sime në mënyrë të tillë që të mund të vazhdohet
12 më tej. Komentet e mia me shkrim i kanë dhe ata përpara,
13 kështu që shpresoj që të mos më duhet që t'ia jap fjalën
14 kolegut ose koleges, por gjithsesi, në qoftë se do të jetë e
15 nevojshme duhet t'jua bëj këtë me dije që në fillim.

16 Dua të them që në fillim që pasi dëgjova prezantimin e z.
17 Rees, do të mundohem që të mos cek dhe të mos mbuloj pikat që
18 i mbuloi z. Rees. Sepse kjo është një temë e zakonshme në këto
19 procedura gjyqësore që ka ngjashmëri të jashtëzakonshme
20 ndërmjet dy çështjeve, ndaj të dy të akuzuarve, z. Gucati dhe
21 z. Haradinaj. Shumë prej çështjeve janë të njëjta për të dy
22 këta dëshmitarë. Kështu që në qoftë se nuk i cek disa elementë
23 të caktuar, mos mendoni se nuk i ndjekim këto pista. Ne, pa
24 diskutim që i qëndrojmë të gjitha parashtrimeve me shkrim që
25 kemi dorëzuar përpara dhomës së apelit dhe që i jemi

1 përgjigjur parashtrimeve të Prokurorisë. Kështu që të gjitha
2 çështjet janë të vërteta njësoj.

3 Së pari, dua që të jap disa komente hapëse që kanë të
4 bëjnë me arsyen e dosjes së apelit. Nuk është se do t'i marr
5 të gjitha pikat arsyet e të cilave janë parashtruar për apel
6 por, do të përqendrohem tek ato elementë të cilët mendoj se
7 janë më të rëndësishëm për tu shqyrtuar nga ju, të nderuar
8 Gjykatës të Trupit Gjykues. Do të përfundoj me Arsyen 24 që ka
9 të bëj me dënimin. Ndërkohë kjo do të ndodhë drejt fundit të
10 parashtrimeve të mia.

11 Sa i takon temave hapëse. Besoj që kjo është një temë e
12 cila është e qartë në parashtrimin tonë, që ka të bëjë me
13 procesin e rregullt ligjor, përgjithësisht. Pa diskutim që
14 qëllimi i një procesi të drejtësisë penale, ose i një procesi
15 gjyqësor, është që gjykimi është në thelb të procesit. Gjykimi
16 si i tillë duhet të dënojë fajtorët dhe të lirojë ata të cilët
17 janë të pafajshëm ose kur pafajësia nuk vërtetohet.

18 Megjithatë, në realitet situata është goxha me më shumë
19 ngjyra. Nuk duhet që personat të dënohen për shkak të
20 opinionit të tyre, pavarësisht se kush janë ata dhe
21 pavarësisht se sa persona i ndajnë këto opinione. Dënimi duhet
22 të bëhet vetëm kur fajësia vërtetohet me prova dhe përmes një
23 procesi të drejtë gjykimi.

24 Parimi i procesit të drejtë ose gjykimit të drejtë, duhet
25 të jetë një proces pa derogim. Kështu që nuk dua që t'i

1 referohem referencave klishe, por dua të them që gjykimi i
2 drejtë është një parim i rëndësishëm dhe qëndron në thelb të
3 demokracive.

4 Z. Haradinaj parashtron dhe konsideron se dosja e apelit
5 dhe njoftimi i mëhershëm i apelit, se procedurat nuk kanë qenë
6 të drejta dhe duhet që dënimi të prapësohet në tërësinë e vet.

7 Dhe për këtë arsye padrejtësia e procesit gjyqësor është
8 përcaktuar që në fillim fare të procesit gjyqësor. Z. Rees i
9 preku disa elementë në këto aspekte, për shembull, sa i takon
10 nxjerrjes së informacionit, ndërkohë që unë personalisht
11 dëshiroj që gjithashtu t'i referohem disa arsyeve të tjera të
12 cilat kanë të bëjnë me këtë pikë.

13 Sa i takon gjykimin të drejtë ose procesin të rregullt
14 ligjor, sa i takon përbërjes së Trupit Gjyqësor. Sikurse duhet
15 ta dini që nga Arsyeja 1 kanë ndodhur diskutime të cilat kanë
16 përfshirë zyrtarë të lartë të ZPS-së, përfshirë këtu
17 konsultime me anëtarë të lartë të komuniteteve, për shembull
18 diplomatike, ambasadorë dhe këto janë procese ose diskutime të
19 cilat kanë ndodhur përpara kësaj çështjeje dhe përpara Trupit
20 Gjyqësor.

21 Ne kemi kërkuar si tërheqjen e Presidentes së Dhomave të
22 Kosovës edhe gjithashtu Zëvendës Presidentit. Dhe mendojmë që
23 kjo në vetvete ka të bëjë me gjykimin e drejtë, me procesin e
24 rregullt ligjor dhe ka ndikim të drejtpërsëdrejti në këtë gjë.

25 Po ashtu, ne kemi kërkuar të dhëna ose procesverbalet e

1 këtyre takimeve që na janë refuzuar. Sigurisht që ky
2 parashtrim ndoshta mund të ceket në kuadrin e relevancës.
3 Megjithatë, procesi gjyqësor në vetvete nuk mund të vlerësohet
4 në vakum. Duhet të vlerësohet në kuadrin e asaj çfarë ka
5 ndodhur. Ndërkohë që Prokuroria thjesht ka larë gojën, sa i
6 takon transparencës dhe parimeve të tjera të rëndësishme të
7 cilat janë parashtruar në të gjithë procesin gjyqësor, por
8 gjithashtu edhe në dosjen paraprake të z. Haradinaj.

9 Ashtu sikurse ZPS-ja është munduar të sugjerojë që
10 pretendimet për frikësimin e dëshmitarëve në çështjen konkrete
11 duhet të shihen brenda kontekstit të pretendimeve të tyre që
12 nuk janë fare të lidhura me njëra tjetrën të bëra rreth 2
13 dekada më përpara. Dhe gjykimi duhet parë brenda kontekstit të
14 plotë të asaj që ka ndodhur gjatë hetimeve dhe çfarë ka
15 ndodhur jashtë procesit të gjyqimit.

16 Në thelb në çdo hap z. Haradinaj është paragjykuar nga
17 veprimet ose mos veprimet e ZPS-së, si përpara Gjykatës të
18 Procedurës paraprake, ashtu edhe përpara Trupit Gjykses.

19 Janë ngritur 24 arsye të veçanta të ankesës në dosjen e
20 apelit. Kohëzgjatja dhe kompleksiteti i aktgjyqimit e
21 justifikojnë edhe madhësinë e dosjes. Kjo kohëzgjatje dhe ky
22 kompleksitet ju ka bërë ju, të nderuar Gjykatës, që të
23 zhvilloni këtë seancë dëgjimore për të mundësuar shtjellimin e
24 mëtejshëm të parashtrimeve.

25 Qëllimi nuk është që të trajtojmë çdo arsye apeli në

1 mënyrë të izoluar, por për këtë arsye unë kam përdorur një
2 qasje selektive.

3 Fjalën time do ta përdor për të shtjelluar dhe plotësuar
4 argumentet e ngritura në dosjen e apelit dhe në përgjigjen
5 ndaj dosjes së ZPS-së. Sigurisht që neve jemi dakord me të
6 gjitha parashtrimet e bëra më përpara, megjithatë unë do t'i
7 referohem pikave të cilat janë të rëndësishme për të dhënë
8 kontekst parashtrimeve shtesë.

9 Qëllimi i kësaj seance nuk është që të përsëriten gjërat
10 të cilat janë thënë më përpara dhe dua ta theksoj edhe njëherë
11 tjetër atë çfarë e thashë që në hyrje të këtij parashtrimi. Në
12 hyrje është thënë se gjykatat gjykojnë çështje, por herë pas
13 here çështjet i gjykojnë gjykatat. Dhe mendojmë që kjo është
14 një deklaratë e cila është me vend e thënë në kontekstin e
15 këtij procesi gjyqësor.

16 Kur është hapur kjo çështje kundër z. Haradinaj, unë kam
17 thënë që gjykatat gjykojnë çështjet, apo çështjet herë pas
18 here gjykojnë gjykatat. Mendojmë që kjo deklaratë është shumë
19 e vërtetë për këto procedura penale. Kjo është çështje e cila
20 ka çuar në aktgjykim dhe sërish aktgjykimi është apeluar dhe
21 ajo çfarë do të ndodhë në këtë çështje, në fakt do të
22 përcaktojë tonin edhe për çështje të tjera të cilat do të
23 vendosen më pas.

24 Për rrjedhojë, ju keni një përgjegjësi shumë të madhe, të
25 nderuar Gjykatës, dhe njësoj përgjegjësi shumë të madhe kam

1 unë, z. Rees dhe gjithashtu edhe Prokuroria. Kjo është
2 përgjegjësi e jashtëzakonshme që procedurat janë të drejta. Ka
3 pasur kritikë sa i takon arsyeve të gjera sa i takon gjykimit
4 të drejtë apo procesit të rregullt ligjor. Megjithatë,
5 sigurisht, të nderuar Gjykatës, ju duhet të keni parasysh
6 faktin që procesi gjyqësor në tërësi është konsideruar një
7 proces që iu ka dhënë drejtësi palëve. Megjithatë, të nderuar
8 Gjykatës, ju do t'ju duhet ta shqyrtoni këtë gjë kur të
9 shikoni apelin në tërësinë e tyre për të ditur nëse procedurat
10 penale në këtë çështje kanë qenë të drejta apo jo. Ndërkohë që
11 parashtrimi ynë është që procedurat nuk kanë qenë të drejta.

12 E gjithë çështja e Prokurorisë mbështetet në tre anëtarë
13 të personelit të ZPS-së, dy prej të cilëve kanë dhënë prova që
14 ne i kemi parashtruar me shkrim që janë prova jo të besueshme,
15 në rastin më të mirë, dhe herë pas here nuk janë as të
16 ndershme. Ndërkohë që dëshmitari i tretë, siç mund ta kujtoni,
17 kujtesa e të cilit ishte e kufizuar lidhur me atë çfarë kishte
18 ndodhur në ngjarjet e vitit 2020. Ndërkohë që dëshmitari i
19 fundit, një gazetar z. Berisha, e minoi çështjen e Prokurorisë
20 dhe i dha më shumë rëndësi një ndër pjesëve më kryesore të
21 Mbrojtjes, në rastin e Haradinajt. Nuk tha gjë tjetër veçse
22 justifikoi që veprimet e tij ishin në interes të publikut, një
23 tezë që e kishim edhe ne.

24 Kur shikojmë aspektin e konfidencialitetit të
25 dokumentacionit, është e rëndësishme për ne të kujtojmë që

1 ZPS-ja ka lejuar ose ka ndihmuar rrjedhjen e dokumenteve nga
2 zyrat e saj. Është personi që i ka sjellë ato dokumente në
3 selinë e OVL UÇK-së personi që ka shkelur konfidencialitetin,
4 në qoftë se konstatohet se këto dokumente do të ishin
5 konfidenciale. Gjithsesi, nuk do të futem tek hollësitë që i
6 ngriti z. Rees lidhur me faktin që ne nuk kemi pasur mundësi
7 që të shikojmë se çfarë ishin këto dokumente, në kuptimin që
8 të kishim mundësi që të përcaktonim në qoftë se vërtetë këto
9 dokumente ishin konfidenciale apo jo. Këtë gjë nuk e ka bërë
10 as Trupi Gjykses dhe as Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

11 Në fjalët e z. Haradinaj, ai ka bërë atë çfarë ai e ka
12 konsideruar të jetë në interes të publikut. Asgjë më shumë dhe
13 asgjë më pak. Ai vetë nuk ka qenë i përfshirë në rrjedhjen e
14 informacionit dhe kjo gjë është konfirmuar dhe nga
15 parashtrimet fillestare të Prokurorisë. Frika më e madhe e
16 përfshirjes së inteligjencës serbe në këtë proces, janë
17 provuar. E kemi parë në fund të Trupit Gjykses daljen në pah
18 të provave të cilat tregojnë dhe dëshmojnë përfshirjen e
19 Serbisë për formësimin e këtij procesi. Dhe ky në fakt ka qenë
20 i vetmi motivim për bërjen publike të këtyre dokumenteve nga
21 klienti im.

22 ZPS-ja ka thënë në deklaratën e vet hyrëse se e vërteta
23 është themeli i drejtësisë. Në hapjen e çështjes nga ana e
24 Mbrojtjes, unë kam deklaruar që klienti im ka vepruar në
25 interes të drejtësisë dhe për këtë arsye ne kemi thirrur

1 prova, kemi thirrur sinjalizues gjithashtu, në mënyrë të tillë
2 që të mund të bëjmë përcaktimin e veprimeve të klientit tim.

3 Ne mendojmë që Gjykata duhet që të shikojë interesin e
4 publikut, në kuadër të përgjithshëm. Kërkojmë nga Gjykata që
5 të bëjë punën e vet për zbulimin e të vërtetës. Ndërkohë që
6 kemi të bëjmë në rastin në fjalë me kurthin, me shtytjen, për
7 kryerjen e veprës nga agjentët e Serbisë apo nga aleatët e saj
8 për të ndihmuar mbulimin qartazi të padepërtueshëm të
9 sekreteve që ajo ka hedhur mbi këtë çështje.

10 Që të kthehet besueshmëria e institucionit, do të duhet
11 që të largohet aroma e manipulimit dhe e pandershmërisë. Kjo
12 është ajo çfarë neve kërkojmë.

13 E thashë edhe në fillim fare që në fakt nxjerrja e
14 informacioneve të materialeve ka qenë një ndër gjërat
15 kryesore, ndër elementët kryesorë të çështjes në fjalë. Kështu
16 që do të dua që të flas për Shkaqet 1, 4, 10 dhe 17, të cilat
17 merren më gjerësisht me çështjen e nxjerrës së informacioneve.
18 Megjithatë, është e rëndësishme që të thuhet që për të gjitha
19 pikat e apelit ose arsyet e apelit të parashtruar në dosjen
20 tonë, Trupi Gjykues nuk ka qenë në gjendje që të japë një
21 shpjegim të duhur.

22 Këto 4 arsye kanë të bëjnë me nxjerrjen. Kanë të bëjnë me
23 nxjerrjen ose me mos nxjerrjen e dokumenteve, e cila në fakt
24 është një temë që është përsëritur në mënyrë të vazhdueshme
25 gjatë gjithë këtij procesi.

1 Ne kemi kërkuar që të vlerësohet në qoftë se Mbrojtja dhe
2 ZPS-ja kanë qenë të trajtuara në mënyrë të barabartë. Në qoftë
3 se konstatohet se nuk ka pasur barazi ndërmjet palëve, atëherë
4 parimi i parashikuar në nenin 6 është shkelur dhe për këtë
5 arsye apeli duhet që të pranohet mbi këtë pikë të barazisë së
6 armëve të palëve.

7 Parashtroj se për çdo vlerësim kjo çështje nuk merr
8 përgjigje pozitive. ZPS-ja i ka bërë bisht gjatë gjithë kohës
9 detyrimeve të saj për të nxjerrë informacione, ka dhënë një
10 numër të konsiderueshëm të parashtrimeve me shkrim dhe ka
11 dhënë pozicionin e saj se cilat janë arsyet e mosnxjerrjes së
12 informacionit, ndërkohë që ZPS-së nuk i është kërkuar që të
13 përmbushë detyrimet e saj për nxjerrje. Këtë e kemi parë në
14 veçanti në dy rastet e fundit.

15 Të nderuar Gjykatës, në 2-3 minutat në vijim do të bëj
16 një përshkrim të përgjithshëm të situatës, në mënyrë që të
17 sigurohem që të mos na duhet të kalojmë në seancë të mbyllur.

18 Më 27 janar të këtij viti, ZPS-ja ka pranuar materialin
19 206 dhe e ka njoftuar Mbrojtjen vetëm pas shpalljes së
20 gjykimit me këtë material, me materialin 206. Ky është
21 parashtrimi i protokolluar F00075 që përmendet në paragrafin
22 44. Trupi Gjykues tha që, mosdorëzimi i këtij dokumenti nuk e
23 dëmtonte Mbrojtjen. Megjithatë, konsideron se shpjegimi i
24 vonesës e arsyetonte njoftimin e vonuar dhe arritën në
25 përfundimin se ZPS-ja kishte shkelur detyrimin e saj për

1 njoftim sipas Rregullit 102(3) të Rregullores.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, neve e
3 kundërshtojmë këtë pjesë të apelit sepse shkon përtej fushës
4 së veprimit të Trupit Gjykues të Apelit dhe e rendit të ditës
5 për ditën e sotme.

6 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Të nderuar
7 Gjykatës, mund t'i përgjigjem Prokurorit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Më duket
9 sikur kemi rënë dakord për këtë pikë, apo jo? E kemi marrë
10 vendimin lidhur me këtë.

11 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Të nderuar
12 Gjykatës, unë këtë po e përdor si shembull të mëtejshëm.
13 Sigurisht ju keni marrë vendim lidhur me këtë pikë dhe keni
14 vendosur që ZPS-ja ka shkelur detyrimin e saj sipas rregullit
15 102(3) të Rregullores. Thjesht këtë po e përdor si shembull
16 për të ilustruar që sjellja e ZPS-së ka qenë e padenjë, sa i
17 takon nxjerrjes së dokumenteve. Megjithatë, në qoftë se ju
18 vendosni kështu, mund të kalojmë në një tjetër element.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ju lutem,
20 vazhdoni.

21 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Atëherë, në
22 qoftë se do të shikojmë nxjerrjet e porealizuara për çështje
23 të ndryshme, atëherë thjesht unë ju solla në vëmendjen tuaj si
24 ilustrim, për të demonstruar atë që po thosha më përpara se
25 çfarë ka bërë ZPS-ja për mosnxjerrjen e dokumenteve. E pranoj

1 atë çfarë thatë ju, të nderuar Gjykatës, lidhur me këtë pikë
2 dhe pranoj që të vazhdoj më tej me elementë të tjerë të
3 prezantimit tim.

4 Dua të them që, që prej fillimit të kësaj çështje, ZPS-ja
5 ka dhënë pozicionin e vet që dokumentet të cilat pretendohen
6 që të jenë rrjedhur, nuk do t'i jepen, nuk do t'i bëhen të
7 ditur Trupit Gjykues apo Mbrojtjes. Kështu që Mbrojtja nuk ka
8 pasur asnjë lloj mundësie që të analizojë këto dokumente. Këtë
9 gjë e kemi ngritur herë pas here gjatë gjithë procesit
10 gjyqësor. Megjithatë, kjo është një gjë e cila e ka penguar në
11 mënyrë të rëndë Mbrojtjen që të mbrojë çështjen e vet për një
12 element që është thelbësor, përkatësisht çështjen që ka të
13 bëjë me 3 paketat e informacionit. Dhe këto 3 paketa nuk i
14 janë dhënë palëve në mënyrë të tillë që Mbrojtja të ketë
15 mundësi që të kishte mbrojtur veten siç duhet.

16 Siç e tha dhe z. Rees, ne e kemi pasur të pamundur të
17 përcaktojmë -- në lidhje me paketën 2, materiali që nuk është
18 konsideruar si konfidencial ose jo publik, siç e përmenda edhe
19 më parë këto janë dokumente të cilat nuk i janë vënë në
20 dispozicion as Mbrojtjes, ashtu siç ka ndodhur edhe me pjesën
21 më të madhe të materialit në paketën 1 dhe paketën 3.

22 Shqetësimi që është ngritur në mënyrë të vazhdueshme
23 është se Trupi Gjykues ka marrë një vendim, ndërkohë që nuk ka
24 pasur mundësi të shqyrtojë përmbajtjen e dokumenteve.

25 Sërish, nuk po sugjerohet që çdo pikë duhet që të

1 ringrihet në apel. E pranoj këtë gjë. Megjithatë, çështja
2 është që duhet të shikohen marrëdhëniet dhe duhet të shikohet
3 gjithashtu edhe detyrimi i ZPS-së edhe rregullsia e procesit
4 gjyqësor.

5 Apo cili duhet të ketë qenë përfundimi, në qoftë se do të
6 ishin respektuar këto detyrime.

7 Sa i takon vetë ZPS-së. Siç e kemi parë në mënyrë të
8 përsëritur, ZPS-ja dukej sikur ishte arbitri i materialeve që
9 duhej që të nxirreshin apo jo. Ne themi që, jo vetëm që ka
10 pasur shkelje të nenit 6 të Konventës, por ka pasur shkelje
11 gjithashtu edhe të rregullës 102(3) dhe 130 [sipas përkthimit]
12 të Rregullores.

13 Kemi paragjykim, kemi cenim të palëve dhe këtë në fakt e
14 parashtrojmë edhe në të katër arsyet që ne kemi dhënë, për
15 arsyet e apelit të këtij vendimi.

16 Mund të ekzistojë prezumimi që ZPS-ja po vepron në
17 mirëbesim. Megjithatë, në shumë raste ZPS-ja na ka vërtetuar
18 që prezumimi nuk qëndron. Ka dyshime të cilat janë mbështetur
19 nga nxjerrja e materialeve të mëtejshme edhe gjatë gjykimit
20 apo edhe fakti që dokumentet nuk na janë vënë në dispozicion
21 dhe që nuk mund të çojnë në përfundimin që procesi gjyqësor ka
22 qenë i rregullt dhe ka qenë i drejtë për të gjitha palët.

23 Ne i jemi referuar çështjes Rowe dhe Davis kundra
24 Mbretërisë së Bashkuar përpara Gjykatës Evropiane të Drejtave
25 të Njeriut. Këtë mund ta gjeni në paragrafin 33 [sipas

1 përkthimit] të parashtrimeve tona me shkrim.

2 Parashtrojmë që kjo ka ndodhur edhe në këtë rast, ZPS-ja
3 ka marrë vendime të cilat nuk ka të drejtë që t'i marrë dhe i
4 ka dëmtuar palët e tjera përmes këtyre vendimeve që ka marrë.

5 Tani më lejoni që t'i referohem Arsyes 12 dhe 13. Në
6 dosjen tonë, Arsyet 12 dhe 13 lidhen me shtytjen për kryerjen
7 e krimit. Ndërkohë që këtu do t'i konsideroj së bashku.

8 Është identifikuar në kundërpërgjigje, ose përgjigja ndaj
9 kundërpërgjigjes së Prokurorisë, që për shkak të një gabimi
10 administrativ, parashtrimet e dosjes së apelit nuk përmbanin
11 atë që janë të rëndësishme për Arsyen 12. Po ashtu, duke marrë
12 parasysh presionin e kufizimit të respektimit të numrit të
13 lejuar të fjalëve, i cili ka çuar në mospërputhje midis
14 njoftimit të Apelit të dosjes së apelit, neve parashtrojmë se
15 këto mangësi nuk janë kaq të vogla. Nuk janë gabime
16 administrative të tilla që nuk duhen të merren parasysh.

17 Arsyet 12 dhe 13 merren me pamundësinë e Trupit Gjykses
18 që të hetojnë burimin e rrjedhjes së ZPS-së, në mënyrë të
19 përshtatshme ose fare, duke transferuar kështu barrën tek
20 Mbrojtja për të mbështetur pretendimet e veta për
21 besueshmërinë. ZPS-ja pretendon se meqenëse njoftimi i apelit
22 nuk e përmend këtë gabim të supozuar ligjor për Arsyen 12 apo
23 gjetkë dhe parashtresat e ankuesit në këtë çështje janë në
24 dosjen e apelit shkon përtej fushës së veprimit të Njoftimit
25 për Apel deri në atë masë duhet të rrëzohen që në fillim.

1 Madje, ZPS-ja vazhdon më tej të pretendojë që për shkak
2 se parashtrimet në dosjen e apelit nuk përkojnë me atë që
3 thuhet në arsyen në njoftim, duhet që të refuzohet e gjithë
4 kërkesa. Ne mendojmë që e kundërta duhet që të merret
5 parasysh.

6 Në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së, ne mendojmë që
7 Arsyet 12 dhe 13 të dosjes së apelit janë të nënkuptuara në
8 Arsyen 16 në Njoftimin e Apelit, ku thuhet mes të tjerash:

9 "Trupi Gjykues ka bërë gabim në zbatimin e ligjit duke
10 mos kryer testin e duhur ligjor për Mbrojtjen e thirrur në
11 vënien e kurthit, pasi kjo është një çështje e cila është
12 ngritur nga Mbrojtja".

13 Ndërkohë që paragrafi 837 përcakton kushtet për
14 respektimin e nenit 6 të Këshillit Evropian të Drejtave të
15 Njeriut. Gjithashtu kërkohet që në rastet kur kemi të bëjmë me
16 nxitjen e kurthit ose me provat *prima facie* të vënies së
17 kurthit, Gjykata duhet të shqyrtojë faktet e çështjes dhe të
18 ndër marrë hapat e nevojshme për të zbuluar nëse ka pasur një
19 shtytje në kryerjen e veprës penale apo jo, përmes një
20 procedure ballafaqese të plotë gjithëpërfshirëse dhe
21 vendimtare. Është për të ardhur keq që nuk ka përputhje të
22 plotë mes të dyjave, por rrëzimi nga ZPS-ja sipas nesh, është
23 tërësisht joproporcionale dhe është e pajustificuar.

24 Me gjithë kapacitetet e kufizuara për të hetuar, Mbrojtja
25 ka mbledhur prova rrethanore në mbështetje të shtytjes në

1 kurth dhe pavarësisht pozicionit të ZPS-së edhe mungesën e
2 provave që kishte për të pasur dokumente, pavarësisht nga të
3 gjitha refuzimet e ZPS-së për dhënien e dokumenteve përkatëse.
4 Kjo jepet me shumë hollësi në paragrafin 140 të dosjes së
5 apelit.

6 Trupi Gjykses, në parashtrimet tona, ka gabuar që t'i
7 përgjigjet pretendimeve të besueshme të Mbrojtjes dhe ia ka
8 caktuar pa të drejtë barrën e provës Mbrojtjes.

9 ZPS-ja është shpërfillëse ndaj argumenteve të z.
10 Haradinaj në këtë aspekt. ZPS-ja thotë se duhet që të
11 përqafohen gjetjet ose konstatimet e Trupit Gjykses. Ndërkohë
12 që parashtrimet e panelit edhe një herë quhen ose konsiderohen
13 si me pasaktësi, duke shtrembëruar provat dhe aktgjykimin. Kjo
14 parashtrohet në paragrafin 147 të dosjes së Prokurorisë.

15 Ka shumë defekte. ZPS-ja thekson se pretendimi i
16 Mbrojtjes për mungesë provash ka të bëjë me një boshllëk të
17 provave që ai dhe i bashkëakuzuari tjetër, kishin ftuar
18 njerëzit që t'i jepnin shumë dokumente dhe t'i bënin publike
19 këto dokumente në selinë e OVL UÇK-së.

20 ZPS-ja ka paraqitur 3 prova: që z. Haradinaj kishte bërë
21 ftesë për më shumë dokumente pas 2 paketave të para; që më pas
22 të tretën e kishte ftuar personi që kishte dorëzuar paketën e
23 tretë të informacionit që të jepte dhe CD e përmendur duke u
24 zotuar që do ta botonte atë; dhe së treti, që pas zbulimit të
25 tre paketave, të dy të akuzuarit kanë përsëritur gatishmërinë

1 e tyre për të botuar çdo material tjetër që do të dërgohej në
2 selinë e OVL UÇK-së.

3 Të gjitha ftesat janë bërë pas dy dërgesave të para dhe
4 natyrisht që nuk mund të jenë dëshmi se z. Haradinaj ka bërë
5 ftesë për to. Dhe shprehja e vullnetit për të bërë publike, në
6 asnjë kuptim, nuk është ftesë për rrjedhje dokumentesh. Kështu
7 që e vërteta është që ZPS-ja nuk ka bërë asgjë në mënyrë të
8 tillë që të ndërpritej rrjedhja e dokumenteve që ndodhi në
9 shtator të vitit 2020.

10 ZPS-ja pretendon se -- pretendimi që nuk është marrë
11 asnjë veprim nga ZPS-ja për të parandaluar ose zhbinder të
12 akuzuarit nga nxjerrja e informacionit, shpërfill provat e tre
13 urdhrave gjyqësor të ZPS-së. Megjithatë, provat e tre urdhrave
14 thjesht nuk bien ndesh me pohimin e dosjes së apelit. Ato
15 vetëm e ndalojnë shpërndarjen e materialeve që do të
16 shpërndahej.

17 Një parashtrim tjetër i ZPS-së ka të bëjë me deklaratën
18 në dosjen e apelit të Trupit Gjyqësor që, "demonstrohet se nuk
19 ka një supozim në favor të ZPS-së duke deklaruar, për
20 shembull, se nuk ka asnjë tregues që paketa e tretë kishte
21 rrjedhur qëllimisht nga ZPS-ja".

22 Ndërkohë, prezumimi i përgjithshëm në favor të ZPS-së
23 është paraqitur në Arsyen 1 në dosjen e apelit dhe në
24 përgjigje. Provat rrethore provojnë se përgjegjësia e ZPS-së
25 për rrjedhjen është referuar më herët. Për më tepër,

1 dokumentet e rrjedhura supozohet që janë prodhuar apo marrë
2 nga ZPS-ja, që tashmë pretendojnë se është fajtor z. Haradinaj
3 për krimet e pretenduara.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] E dëgjuat?

5 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Kërkoj ndjesë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Po flisni
7 shumë shpejt. Ju lutem më ngadalë.

8 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Kërkoj ndjesë
9 për këtë.

10 Po i kthehem përsëri.

11 Provat rrethanore sugjerojnë përgjegjësinë e ZPS-së për
12 rrjedhjen e këtyre dokumenteve. Ky është paragrafi 140 i
13 dosjes së apelit. Për më tepër, dokumentet që rrodhën janë
14 prodhuar ose janë marrë nga ZPS-ja, që tashmë për këtë arsye
15 ndiqet penalisht z. Haradinaj për krimet e pretenduara lidhur
16 me këto dokumente.

17 Shkurtimisht, çështja *prima facie* për shtytjen e veprës
18 penale është e fortë dhe Trupi Gjykses nuk mori hapat
19 përkatëse lidhur me këtë.

20 Tani do të kaloj tek apelet e z. Haradinaj lidhur me disa
21 pika individuale, për të cilat u shpall fajtor.

22 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Z. Cadman, a mund t'ju
23 bëj një pyetje? Sa i takon pragut për të vërtetuar argumentin
24 tuaj të shtytjes për veprën penale. Ky standard që nuk është i
25 përshtatshëm. Ku është ky prag në parashtrimet tuaja, mund të

1 na e tregoni sa i takon provave që duhen paraqitur lidhur me
2 këtë?

3 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Është
4 përcaktuar me hollësi në dosjen tonë, ku ne diskutojmë çfarë
5 është standardi. Janë dy aspekte që janë ngritur gjatë
6 zhvillimit të gjykimit, sa i takon standardit të pa
7 pranueshmerisë dhe informacioni për të cilin përdori Trupi
8 Gjykses ish-in në parashtrimet tona, tejkaloi testin e
9 standardit të pamundësisë.

10 Pika e dytë që u ngrit, dhe kam frikë se nuk kam
11 autoritetin për t'ju kthyer, por pika kur Trupi Gjykses e
12 rishikoi, e shqyrtoi materialin që nuk i është nxjerr
13 Mbrojtjes dhe pastaj del me konstatim sa i takon pamundësisë,
14 ndërkohë që Mbrojtja nuk mund të bënte parashtrime në lidhje
15 me këtë. Për mendimin tonë kjo është një shkelje e nenit 6 dhe
16 kjo është nga pikat që ne e kemi ngritur.

17 Tani, sigurisht është sugjeruar ne duhet të shohim nëse
18 materiali në fjalë, materialet 1, 2, 3, kanë dalë nga ZPS-ja
19 dhe ky material është specifikuar nga ish-Prokurori se z.
20 Haradinaj nuk luajti asnjë rol në mënyrën se si rrodhi ky
21 informacion, u vodh, apo u përfitua. Pra, nuk luajti kurrfarë
22 roli në mënyrën se si u paraqit ky material, apo mënyrën se si
23 shkoi ky material në zyrat e UÇK-së në Prishtinë.

24 Z. REES: [Përkthim] Thjesht dua të them diçka. Ju bëtë
25 një pyetje.

1 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Doni t'i përgjigjeni ju
2 pyetjes në vend të z. Cadman?

3 Z. REES: [Përkthim] Jo, thjesht dua të flas për
4 paragrafin 332 deri në 339 në dosjen e apelit të Gucatit,
5 sepse aty mund të gjeni përgjigjen e pyetjes suaj.

6 Ju kërkoj ndjesë, z. Cadman.

7 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Z. Cadman, doni të
8 shtoni gjë?

9 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, e vlerësoj
10 ndihmën e z. Rees në këtë çështje dhe është diçka që e kemi
11 parashtruar në dosjen tonë. E kemi përmendur në paragrafët e
12 mëparshëm në dosjet tona, kur flasim për këtë standard, në
13 fakt.

14 Qëndrimi ynë është që, nëse ky pretendim ishte tërësisht
15 i pamundshëm, atëherë faza e dytë nuk do të nevojitej më. Dhe
16 pozicioni ynë qëndroi i tillë gjatë gjithë kohës dhe e
17 vlerësoj ndërhyrjen e z. Rees, por ky prag është tejkaluar.

18 Dhe unë thjesht shtova një pikë shtesë sa i takon pjesës
19 ku Trupi Gjykses shqyrtoi këtë material, një material që
20 sugjeron përfshirjen e të tjerëve, qofshin këto anëtarë të
21 ZPS-së, zyrtarë serb apo kosovarë, nëse ka prova të ndonjë
22 individit që mund të jetë i përfshirë në prokurimin dhe
23 shpërndarjen e këtyre materialeve. Është e qartë që është
24 tejkaluar pragu.

25 Kur Trupi Gjykses shqyrtoi këtë material, por Mbrojtja

1 është përjashtuar nga shqyrtimi i këtij materiali, atëherë kjo
2 është një shkelje e nenit 6. Dhe sikurse e thashë, unë do të
3 flas, do ju jap referenca për këtë çështje në kohën e duhur.
4 Por nuk i kam aktualisht përpara. Megjithatë, gjendet në
5 parashtrimet tona e mirë përcaktuar.

6 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.
7 Dua të flas për çështjen e nxitjes në kryerjen e veprës
8 penale. Si bën pjesë, si e shpjegoni ju që e keni përmbushur
9 këtë aspekt, ose a është pjesë e përmbushjes së pragut,
10 nxitja?

11 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Duhet të ketë
12 një bazë për të bërë këtë sugjerim. Dhe sigurisht, ka pasur
13 njoftime të përditësuara të cilat i ka dhënë ZPS-ja gjatë
14 zhvillimit të gjykimit. Por, të paktën të shërbenin si bazë
15 për të besuar që kishte persona të tjerë të përfshirë.

16 Megjithatë, unë nuk po hyj me hollësi në materiale sepse
17 ju keni marrë vendim për atë, të nderuar Gjykatës. Qëndrimi
18 ynë gjatë gjithë procedurave ishte i atillë që nuk ishte
19 thjeshtë një pretendim kundër ZPS-së, por ishte një pretendim
20 kundër dhe individëve të tjerë, mundësisht autoritete serbe,
21 të cilët mund t'i kishin dhënë këto materiale, mund të kishin
22 qenë burimi i këtyre materialeve.

23 Problemi është, a ka një bazë që është më shumë se e
24 mundshme për të besuar se pretendimi për nxitje apo shtytje në
25 veprën penale, është përmbushur? Qëndrimi ynë është shumë i

1 qartë që ka bazë për të besuar se këto materiale duhet t'i
2 ishin nxjerrë Trupit Gjykues. Të kishim pasur dhe ne mundësi
3 t'i shqyrtonin këto materiale që ta çonim më tej aspektin e
4 pretendimeve.

5 Ne themi që Trupi Gjykues gaboi që nuk na i dha këto
6 materiale.

7 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë do të
9 flisja për Arsyen 18 që është Akuza 1. Edhe njëherë, kërkoj
10 ndjesë nëse do përsëris disa nga gjërat që ka përmendur tashmë
11 z. Rees, por do të përpiqem që të flas sa më shkurt që të jetë
12 e mundur.

13 Për Akuzën 1, z. Haradinaj u shpall fajtor për pengimin e
14 personave zyrtarë përmes kanosjes serioze. Nëse shohim 40(1),
15 paragrafi 1 ku thotë:

16 "Cilido, i cili me forcë a kanosje serioze pengon ose
17 tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave
18 zyrtare ose duke përdorur mjete të njëjta e detyron atë të
19 kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej 3 muaj deri në
20 3 vjet".

21 Arsyeya 18 [sipas përkthimit] ka të bëjë me shtrirjen e
22 fushëveprimit të kanosjes serioze. Ne konsiderojmë se Trupi
23 Gjykues ka gabuar në zbatimin e ligjit kur nxori përfundimin
24 se një kanosje serioze kundër palëve të treta mund të
25 mjaftonte për të mbushur *actus reus* dhe dashje për vepër

1 penale. Si Trupi Gjykues dhe ZPS-ja, kanë zgjedhur ta lexojnë
2 fjalë për fjalë nenin sepse në fakt ashtu lexohet, fjalë për
3 fjalë. Ky është aktgjykimi paragrafi 146 si referencë dhe
4 përgjigja e Prokurorisë është në paragrafin 110.

5 Fjala "kanosje serioze" është e pa cilësuar dhe duhet të
6 kuptohet se përfshin kanosjen serioze ndaj dikujt që nuk është
7 person zyrtar. Ndonjëherë sigurisht që është e përshtatshme
8 dhe duhet lexuar fjalë për fjalë një tekst ligjor. Megjithatë,
9 në qoftë se ka paqartësi për objektin e përkufizimit të një
10 vepre penale, gjithmonë ka arsye për interpretime në mënyrë të
11 kufizuar të ngushtë, në mënyrë që të mos përfshihen aktet që
12 në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohet se nuk janë vepra
13 penale. Neni 2(3) i Kodit Penal të Kosovës thekson një parim
14 të përgjithshëm që është i zbatueshëm. Thjesht për ta cituar
15 pak:

16 "Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale
17 interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet
18 procedura penale".

19 Por, në atë gjykimin e tij, Trupi Gjykues citon një pjesë
20 të komentuar të Salihut dhe të tjerë, në mbështetje të
21 interpretimit të tij. Dhe kjo është paragrafi 146 që citon
22 Salihun dhe të tjerët. Është në faqet 1165, 1166. Dhe vendimi
23 F74. Dhe pasazhi përkatës është si në vijim:

24 "Kanosja duhet t'i drejtohet personit zyrtar me qëllimin
25 e pengimit të kryerjes së detyrave zyrtare. Megjithatë, mund

1 t'i drejtohet edhe një personi ose objekti tjetër."

2 Konsiderohet se Trupi Gjykses e ka keqkuptuar komentarin
3 në këtë pikë. Nuk ka pasur për synim të lejojë mundësinë që
4 kanosja serioze t'i drejtohet ekskluzivisht dikujt tjetër që
5 nuk është person zyrtar. Përkundrazi, lejon që një kanosje e
6 vetme serioze t'i drejtohet si personit zyrtar, ashtu edhe një
7 personi apo objekti tjetër. Për shembull, një kryes mund të
8 informojë një polic dhe familjen e tij se të gjithëve do t'ju
9 shkaktohen dëme të rënda në rast se polici nuk bën një shkelje
10 të caktuar të detyrave të tij zyrtare. Mund ta gjeni këtë në
11 poshtëshënimin tonë 171, në dosjen e apelit.

12 Por për shkak se ka pasur kanosje serioze ndaj policit,
13 vepra mund të cilësohet në kuadër të nenit 401(1). Nëse dikush
14 pengon një person tjetër me forcë ose kanosje serioze, është
15 krejt e natyrshme të kuptohet se forca ose kanosja t'i jenë
16 drejtuar personit të penguar. Nga kjo konsiderohet se neni
17 synonte të kishte një objekt më të gjerë, atëherë --

18 Ndjesë për shpejtësinë.

19 Në fakt, unë i kam dhënë paraprakisht disa shënime. Në
20 fakt po i lexoj disa prej tyre dhe po i përmbledh për të
21 ndihmuar me përkthimin. Me sa kuptoj nuk është se po ndihmon
22 shumë, kështu që do të ngadalësoj ritmin tim.

23 Pra, po thosha, nëse dikush pengon një person tjetër me
24 forcë ose me kanosje serioze, është krejt e natyrshme të
25 kuptohet se forca ose kanosja t'i jenë drejtuar personit të

1 penguar. Nga kjo konsiderohet se nëse neni synon të kishte një
2 objekt më të gjerë, kjo do të ishte shprehur në formulimin e
3 tij.

4 Dhe këtu i referohem fundit të këtij parashtrimi në
5 ankesën e përgjithshme që u bë gjatë zhvillimit të gjykimit
6 dhe në kuadër të apelit, sepse Mbrojtja u ftua të bënte
7 parashtrime lidhur me elementët e veprave penale dhe një nga
8 vështirësitë që hasëm në konkretisht, ishte pikërisht se pasi
9 i bëmë parashtrimet mbi elementët e veprave penale të cilat
10 kishin ndikim të drejtpërdrejtë për mënyrën sesi do të kryhej
11 edhe ishin argumentet mbrojtëse, këto nuk u morën parasysh
12 asnjëherë në gjykim.

13 Shumë prej këtyre çështjeve mund të ishin trajtuar duke
14 përcaktuar cilët janë elementët dhe shkalla e shtrirjes së
15 dispozitës, sepse është shumë e qartë që ka pasur dallim
16 opinionesh mes Prokurorisë e Mbrojtjes dhe këto çështje nuk u
17 zgjidhën. Nuk u trajtuan në gjykim dhe patën ndikim të
18 drejtpërdrejtë në mënyrën se si mund të ishte zhvilluar dhe
19 faktikisht u zhvillua gjykimi.

20 Doja të trajtoja edhe Arsyet 19 dhe 20 që janë të Akuzës
21 3. Por, duke pasur parasysh fokusin e parashtrimeve të z. Rees
22 lidhur me këto, ai i trajtoi shumë këto pika në apelin e tij.
23 Kështu që nuk po i përsëris edhe një herë. Ne pajtohemi me të
24 njëjtin qëndrim. Nga ana e Mbrojtjes së Haradinaj si dhe
25 interpretimi i saktë kështu që do doja të kaloja në pikën

1 tjetër, për të mos përsëritur të njëjtat pika.

2 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Z. Cadman, a mund t'ju bëj
3 ndonjë pyetje për nenin 401(1)?

4 Kjo dispozitë parashikon tentativën e kryerjes. Si i
5 paraqisni argumentet tuaja kur keni kryerjen në tentativë të
6 kësaj që parashikon kjo dispozitë?

7 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Pata pak
8 ndërhyrje, a mund ta përsërisni?

9 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Siç mund ta shohim në pikën
10 1, paragrafin 1, nuk është e nevojshme që të përmbushen të
11 gjitha elementët *actus reus* të kësaj vepre penale, por mjaft
12 të tentohet të pengohet një person zyrtar. Pyetja ime është,
13 nëse e kuptova argumentin tuaj lidhur me përmbushjen e
14 elementëve të veprës penale por jo përpjekjen për të kryer
15 këtë vepër penale, desha t'ju pyes nëse argumenti juaj është
16 po aq i vlefshëm nëse ju e konsideroni po njësoj tentativën në
17 kryerjen e një vepre penale? S'e di a më kuptuat?

18 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, e kuptova
19 pyetjen tuaj.

20 Ajo që parashtrova unë në parashtrimet me shkrim edhe
21 gjatë gjykimit, ishte se mënyra sesi u formulua akuza apo
22 pika, pozicioni ynë është që nuk kishte prova nëse ky pengim
23 apo tentim për të penguar persona zyrtarë, ndodhi në të
24 vërtet. Qëndrimi im është i njëjtë, nuk pati asnjë provë që të
25 tregonte që pati pengim të personave zyrtarë.

1 Ajo që po përpiqesha të thosha unë ishte, nëse marrim
2 persona të tjerë që nuk janë persona zyrtarë por, besoj se kjo
3 vlen si për tentativën edhe për kryerjen konkrete, pengimin
4 konkret të drejtësisë. Mendoj që ky është pozicioni ynë.

5 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Si një eksperiment të
6 shkurtër, për shembull, unë mund të kërcënoj një dëshmitar
7 privat me synimin dhe tentoj të pengoj një person zyrtar në
8 ushtrimin e detyrave të veta. Nga pikëpamja logjike, a është
9 ky një interpretim i mundshëm?

10 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nëse do të
11 kishte kanosje, atëherë po, është një interpretim i mundshëm.
12 Nëse e mbështesin dhe provat patjetër. Ne themi se nuk kishte
13 prova për ta mbështetur këtë gjë.

14 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Siç ju thashë,
16 nuk do të trajtoj Akuzën 3. Sepse Akuza 3 është edhe pika më
17 thelbësore, por nuk po hyj tani në një pikë që do të
18 përsëriste parashtrimet që tha më herët z. Rees.

19 Doja të thosha që ne pajtohemi me ato që u thanë
20 paraprakisht në Arsyen 18 të parashtrimeve me shkrim, të cilat
21 gjenden në dosjen tonë të apelit. Tani do të kaloj tek Arsyeya
22 21, që është Akuza 5.

23 Kjo është shkelja e sekretit të procedurës përmes
24 zbulimit të paautorizuar të informacionit sekret të zbuluar në
25 procedurë zyrtare.

1 Ne e kundërshtojmë këtë konstatim në Arsyen 21 që shpreh
2 se Trupi Gjykses ka gabuar në zbatimin e ligjit ku konstatohet
3 se trajtimi i SITF ZPS-së si dokumente të caktuara si
4 konfidenciale kulmojmë me deklarin e informacionit të
5 përfshira në dosjet sekrete sipas nenit 392(1) të Kodit Penal
6 të Kosovës, duke mos marrë parasysh përkufizimin e
7 legjislacionit vendas, sa i takon informacionit të fshehtë.

8 Po të lexojmë nenin 392(1), thotë:

9 "Kushdo që pa autorizim zbulon informata për të cilat
10 është njoftuar në procedurën zyrtare që sipas ligjit nuk mund
11 të zbulohen apo ato informata janë shpallur si sekrete me
12 vendim të gjykatës apo organet kompetente, dënohet me gjobë
13 ose me burgim deri në një vit".

14 Z. Haradinaj ngarkohet në aktakuzë me informacione
15 sekrete dhe jo informacione që nuk duhen zbuluar sipas ligjit.

16 Parashtrimi ynë është që informacioni sekret përkufizohet
17 në nenin 612 të Ligjit për Klasifikimin e Informacionit dhe
18 Verifikimit të Sigurisë, si "informacione, hapja e
19 paautorizuar e të cilave mund të dëmtonte seriozisht interesat
20 e sigurisë së Republikës së Kosovës". Dhe në dosjen tonë të
21 apelit themi që nuk ka asnjë provë të jetë paraqitur që
22 informacioni që apellesi konstatohet se ka zbuluar, te këtë
23 qenë informacion sekret sipas përkufizimit të këtij ligji.

24 Më lejoni një moment, ju lutem, dua të nder dritën sepse
25 u bë pak errësirë jashtë.

1 Fjalja e fundit që lexova është paragrafi 193 në dosjen
2 tonë të apelit. Është më e shtjelluar në atë paragraf.
3 Përgjigja është një reagim ndaj kundërshtimit të ZPS-së në
4 mënyrën se si kanë zbatuar ligjin për klasifikimin e
5 informacionit dhe verifikimin e sigurisë, të cilën e kemi
6 trajtuar në kundërpërgjigjen që kemi bërë dosjes së
7 Prokurorisë në paragrafin 60 dhe 61.

8 ZPS-ja ka deklaruar se një autoritet kompetent si THFS-ja
9 dhe ZPS-ja që shënon ose trajnon informacionin si
10 konfidencial, kuptohet natyrshëm se i deklaron këto
11 informacione si sekrete, merr vendim sipas kuptimit të nenit
12 392(1) të Kodit Penal të Kosovës. Por, unë do të doja ta
13 shfrytëzoja këtë rast për të shtjelluar arsyet pse ky
14 pretendim është qartazi i pasaktë.

15 Siç tregohet në përgjigje, paragrafi 61, kuptimi i
16 zakonshëm i sekretit është më i ngushtë se ai konfidencial në
17 kontekstin e informacionit. Po ashtu, formulimi i nenit
18 392(1), qartazi ndan dy lloje informacionesh të zbuluara në
19 procedura zyrtare: përkatësisht informacione që nuk duhen të
20 zbulohen sipas ligjit, që në thelb është informacion
21 konfidencial; dhe informacion që është deklaruar si sekret me
22 vendim gjykate ose organi kompetent.

23 Në legjislacion, informacioni konfidencial dallon nga
24 informacioni sekret i cili ka një hapësirë më të ngushtë,
25 objekt më të ngushtë të përcaktuar nga siguria kombëtare.

1 Çfarëdo të ketë nënkuptuar ZPS-ja, Akuza 5 e aktakuzës e
2 ngarkon z. Haradinaj me zbulim të paautorizuar të
3 informacionit sekret dhe jo me zbulim të paautorizuar të
4 informacionit që nuk duhet zbuluar sipas ligjit.

5 Tani, i takon Prokurorisë barra e provës të formulojë
6 aktakuzën në mënyrë të atillë që të mbulojë veprat e
7 pretenduara penale që pretendon se i ka kryer i akuzuari. Dhe
8 në fakt, sigurisht, kjo është baza e shtetit të së drejtës,
9 është parimi themelor i shtetit të së drejtës, që nëse
10 konstatohet që i akuzuari nuk e ka kryer veprën e përmendur në
11 aktakuzë, atëherë ai duhet të lirohet nga kjo akuzë.

12 Tani dua të flas për Arsyen 24 që është dënimi.
13 Sigurisht, do të ketë disa përsëritje të atyre që tha z. Rees,
14 por mendoj që është e rëndësishme që të bëjmë të ditur edhe
15 neve qëndrimin tonë. Referencat që përmendi z. Rees, çështja e
16 fundit që përmendi ai, që do ta përmend edhe unë, duhet të
17 përmbahet e të merret parasysh edhe në çështjen e z.
18 Haradinaj. Kjo thjesht duhej të ishte në listën e dokumenteve
19 që do të ishin nxjerrë.

20 Sa i takon dënimit. Pikësëpari, ne e kemi bërë të qartë
21 në parashtrimet me shkrim dhe sot se z. Haradinaj duhet të
22 shpallet i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Nëse nuk
23 rrëzohen akuzat, atëherë duhet të shkurtohet dënimi.

24 Në Arsyen 24, konsiderojmë që Trupi Gjykues duke marrë
25 parasysh të gjitha rrethanat, ka bërë gabim faktik dhe ka

1 vendosur një dënim qartazi tepër të lartë. Dhe ky është
2 paragrafi 209 i dosjes sonë të apelit. Ne kemi gjetur 5 gabime
3 që ka bërë Trupi Gjykses lidhur me këtë pikë.

4 Pikësëpari, ne përsërisim konsideratat tona në dosjen e
5 apelit dhe kundërpërgjigjen. Megjithatë, doja të shtjelloja
6 pikën 4 në Arsyen 24 që ka të bëjë me jurisprudencën e
7 mëhershme nga gjykatat e tjera ndërkombëtare.

8 Gjatë vendosjes së një dënimi të duhur për z. Haradinaj,
9 Trupi Gjykses deklaroi se kishte marrë parasysh gamën e
10 dënimeve të shqyrtuara ndaj personave të dënuar për vepra të
11 ngjashme në gjykata apo tribunale ndërkombëtarë.

12 Ky është paragrafi 979 i aktgjykimit. Edhe na dha 5
13 shembuj: Marijaçiç, Rebiç dhe Joviç të dyja të TNPJ-së;
14 aktgjykimet dënuese të Akhbar Beirut dhe Al-Khayat të dyja në
15 STL; dhe gjykimi Nzabonimpa që është në IRMCT. Këto kishin
16 poshtë shënimin 2012.

17 Paragrafi kryesor në përcaktimin e dënimit është
18 paragrafi 1004. Trupi Gjykses deklaroi se ka marrë parasysh
19 gamën e dënimeve të shqyrtuara ndaj personave të dënuar për
20 vepra të ngjashme nga gjykatat tribunale ndërkombëtare dhe se
21 ishte e vështirë që të merrej një vendim i duhur për këtë
22 rast, bazuar në një vendim që ishte dhënë më herët për një
23 çështje tjetër. Më pas ka bërë një përmbledhje të veprave
24 penale dhe konstatoi se z. Haradinaj i kishte kryer. Në
25 paragrafin 1006 shqyrtoi dënimet për pikat individuale edhe

1 rezulton me një dënim të përgjithshëm prej 4.5 vjetësh.

2 Tani, kjo është hera e parë që Dhoma e Specializuar e
3 Kosovës del me një aktgjykim. Nuk ka pasur jurisprudenca të
4 mëparshme në këtë drejtim. Dhe ka devijuar shumë nga praktika
5 ndërkombëtare dhe ne mendojmë se kjo është e padrejtë. Ne e
6 pranojmë plotësisht, sikurse e tha dhe z. Rees, që çdo çështje
7 është ndryshe nga tjetra dhe është e vështirë që të gjesh
8 çështje të ngjashme në gjykata apo tribunale të tjerë
9 ndërkombëtarë. Por, dënimi i z. Haradinaj është kaq shumë në
10 dallim, kaq ndryshe nga vendime të tjera që janë marrë në
11 tribunale apo gjykata të tjera, neve në parashtrimin tonë
12 mendojmë që nuk është marrë parasysh praktika bazë që është
13 përdorur në gjykimet e mëparshme.

14 Në çështjet Marijaçiç, Rebiç, Joviç, Akhbar Beirut, Al-
15 Khayat dhe Nzabonimpa, Trupi Gjykses i vlerësoi që ishin të
16 ngjashme dhe në të gjitha këto çështje dënimi ishte goxha më i
17 ulët se sa çështja janë konkrete. Në rastin e Marijaçiç,
18 Rebiç, Joviç, Akhbar Beirut, Al-Khayat dhe Nzabonimpa e të
19 tjerë, që Trupi Gjykses mendoi se ishin të ngjashme, dënimet
20 ishin shumë më të ulëta. Trupi Gjykses i gjeti të dy të
21 akuzuarit në këtë rast fajtorë, duke nxjerrë konkretisht
22 informacion lidhur me procedurat duke e ditur se ka qenë në
23 shkelje të urdhrit të gjykatës.

24 Josip Joviç u akuzua për publikimin e informacionit të
25 materialeve në gazetën e tij lidhur me një dëshmitar të

1 mbrojtur dhe mbasi kishte refuzuar të respektonte një urdhër
2 për të mos e vazhduar publikimin. Këto gjenden në dosjen e
3 çështjes. Trupi Gjykses e deklaroi fajtor atë për nxjerrjen e
4 informacionit në lidhje me procedura, duke e ditur se kishte
5 shkelje të urdhrit të Dhomës gjykesse dhe e dënnoi me 20 mijë
6 Euro.

7 Në çështjen Akhbar Beirut, Al Amin u konstatua se kishte
8 publikuar emra, fotografi dhe të dhëna të rëndësishme
9 personale të 17 dëshmitarëve që mendoheshin se ishin
10 konfidenciale dhe pastaj botoi një informacion tjetër, përsëri
11 materiale lidhur me informacione për 15 dëshmitarë. Kjo është
12 paragrafi 17 i aktgjykimit.

13 Një numër i caktuar dëshmitarësh shprehën frikë. Dy
14 dëshmitarë, në fakt, e humbën besimin në mundësinë e Gjykatës
15 Speciale të Libanit për të ruajtur konfidencialitetin e
16 informacionit të dëshmitarëve. Dhe të paktën njëri tregoi se
17 kishte pësuar dëmtim. Al Min u dënua me 20 mijë Euro gjobë.

18 Çështja Al-Khayat ka të bëjë me 5 episode të transmetuar
19 në televizionin Al Jadded, "Dëshmitarë të Tribunalit
20 Ndërkombëtar". Ato lejuan identifikimin e 3 dëshmitarëve të
21 Gjykatës së Libanit. Në këtë rast, në 10 gusht 2012, Gjykatësi
22 i Procedurës Paraprake në këtë gjykatë nxori një urdhër
23 konfidencial *ex parte* që i thoshte televizionit Al Jadded të
24 mos vazhdonte shpërndarjen e materialit lidhur me dëshmitarët
25 konfidencial.

1 Z. Khayat ishte pjesë e menaxhimit të departamentit të
2 lajmeve në TV dhe kishte mundësi ta hiqte këtë informacion.

3 Çështja e Nzabonimpa është disi e ndryshme nga të tjerat
4 dhe nuk ka të bëjë me nxjerrjen e informacionit. Të akuzuarit
5 janë akuzuar që kanë ndërhyrë me dijeni dhe me dëshirë në
6 administrimin e drejtësisë. Ato kanë marrë pjesë në një
7 përpjekje të organizuar mirë ku janë përdorur pagesa për të
8 nxitur dëshmitarët, në një gjyq gjenocidi, për të tërhequr
9 dëshmitë e tyre.

10 Nzabonimpa - nuk e shqiptoj mirë me siguri dhe për këtë
11 kërkoj ndjesë - Ndagijimana dhe Fatuma kaluan më shumë se 11
12 muaj në paraburgim dhe u dënuan me kohën që kishin qenë aty.

13 Ngirabatware luajti një rol të rëndësishëm në financimin
14 dhe drejtimin e operacionit dhe u dënua me 2 vjet burg.

15 Në secilën nga këto 5 çështje, dënimi maksimal ishte 7
16 vjet burg dhe gjobë, apo të dyja. Të dy llojet e dënimeve u
17 vendosën të gjithë në shkallën më të fundit.

18 Siç e tha z. Rees, edhe ne kemi vënë në dukje çështjen e
19 Margetiç. Siç thashë, çështja IT-95-14-R77.6 e vitit 2007. Siç
20 tha me të drejte z. Rees, ishte një listë dëshmitarësh e
21 publikuar në uebsite me emrat e 102 dëshmitarëve, shumë prej
22 të cilëve ishin me masa mbrojtëse për të siguruar mosnxjerrjen
23 e identitetit të tyre.

24 Trupi Gjykues tha se duke publikuar listën e
25 dëshmitarëve, personi "kishte prapësuar masat mbrojtëse,

1 kishte dobësuar besimin e dëshmitarëve në tribunal". Kjo është
2 në paragrafin 69. Dhe se kjo sjellje kishte gjasa "të ç'bindë
3 dëshmitarët nga dëshmimi".

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ju lutem,
5 mund të flisni pak më ngadalë?

6 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Trupi Gjykses
7 e konsideroi këtë përpjekje shumë të rëndë dhe atij i dhanë
8 dënim 3 muaj me burg dhe një gjobë prej 10 mijë Eurosh. Kjo
9 është ne paragrafin 86 të aktgjykimit.

10 Sigurisht, ka ndryshime në çdo çështje. Dhe të gjitha
11 çështjet e përmendura ndryshojnë shumë nga ajo e z. Haradinaj.
12 Ndryshe nga z. Haradinaj, z. Margetiç publikoi emrat e shumë
13 dëshmitarëve e megjithatë ai mori një dënim shumë më të vogël.

14 Për mendimin tonë, ndryshe nga ajo që thuhet, Trupi
15 Gjykses nuk mori parasysh gamën e dënimeve të dhëna për
16 persona të shpallur fajtor, për veprat e ngjashme, në gjykatat
17 tribunale ndërkombëtare. Për mendimin tim, dënimi i dhënë nga
18 Trupi Gjykses ishte shumë i tepruar lidhur me ato të dhëna në
19 tribunale e gjykata ndërkombëtare dhe që do ishte e barabartë
20 me një gabim në qoftë se nuk kthehet mbraps.

21 Ne thamë në fillim, dhe po e përsërisim, se është një
22 çështje e pazakontë kjo. Dokumentet, që janë esenciale për
23 secilën prej pikave të aktakuzës, nuk i janë nxjerrë
24 Mbrojtjes. Këto dokumente pretendojnë të dalin nga i njëjti
25 organ që po procedon të akuzuarin, ZPS-ja. ZPS-ja, megjithatë,

1 nuk i ka dhënë ndonjë ndihme të akuzuarit në përpjekjet e tyre
2 për të zbuluar se si dokumentet arritën në OVL UÇK, në shtator
3 të 2020.

4 Në një plan më të përgjithshëm, mungesa e nxjerrjes dhe
5 padrejtësia kanë qenë konstante në procedurat në këtë gjykatë.

6 Në parashtrimet e miya dhe në dosjen e apelit,
7 kundërpërgjigjen tonë ndaj dosjes së ZPS-së, i japim arsye për
8 rrëzimin e të gjitha konstatimeve për secilën nga pikat. ZPS-
9 ja ka argumentuar se kjo çështje duhet argumentuar në bazë të
10 shifrave. Ne parashtrojmë se drejtësia nuk shërbehet duke
11 ndjekur një qasje të rreptë. Drejtësia kërkon shumë më tepër.

12 Në fund, unë i kthehem të metave themelore në fazën e
13 gjykimit që ndikojnë të gjithë çështjen e ZPS-së. Mungesa e
14 transparencës nga ana e ZPS-së dhe paragjykimi i treguar ndaj
15 z. Haradinaj si rezultat i ZPS-së dhe Gjykatësit të Procedurës
16 Paraprake, duhet marrë parasysh dhe vendimi duhet prapësuar.
17 Dënimi është i tillë që është jashtëzakonisht i tepruar dhe
18 duhet të pakësohet, në rast se nuk lirohet.

19 Unë u përmbahem të gjitha parashtrimeve të paraqitura në
20 dosjen tonë të apelit dhe kaq kisha për sot, të nderuar
21 Gjykatës.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Këtu përfundojnë të gjitha parashtrimet tuaja?

25 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Juve folët
2 shumë më shkurt se sa prisnim.

3 Keni gjë tjetër për të shtuar z.Rees?

4 Z. REES: [Përkthim] Dua t'ju kërkoj nëse mund ta përdor
5 unë këtë kohë meqenëse përfunduar para kohe. Meqë jemi të
6 gjithë këtu, mund t'i trajtoj disa çështja, disa pyetje që iu
7 bënë z. Cadman.

8 Unë mund t'i lë deri kur të vijë koha e kundërpërgjigjes,
9 por meqenëse jemi këtu, thashë t'i ngre. Sigurisht jam në
10 dorën tuaj.

11 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Në qoftë se më
12 lejoni, do doja të bëj një koment.

13 Sigurisht unë doja t'i përdorja 90 minutat. Por, mbasi
14 dëgjova z. Rees, disa çështja që ai i ngriti nuk kisha pse t'i
15 ngrija dhe unë. Nuk do të ishin në interes të përdorimit
16 efikas të kohës. Prandaj dhe koha që përdora unë ishte më e
17 pakët.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Dhe ne e
19 vlerësojmë këtë gjë. Z. Rees duket se dëshiron ta përdorë
20 kohën që mbeti nga ju. Por jo shumë gjatë, ë?

21 Z. REES: [Përkthim] Do të fokusohem tek pyetjet që u
22 bënë, me shpresën se do t'ju ndihmojë.

23 Së pari, e pyetët z. Cadman se si Mbrojtja pretendon se
24 pengesa e të qenit plotësisht i pamundshëm është përdorur.

25 Në fakt, kjo pengesë është shumë më e ulët se sa në

1 procedurat e tjera. Ne themi se, në fakt, dhe kjo rrjedh
2 drejtpërdrejtë nga Dhoma e Madhe e GJEDNJ, paragrafi 70:
3 "Prokuroria ka detyrë të provojë se nuk ka pasur nxitje për të
4 kryer vepra penale me kusht që akuza të mos jetë plotësisht e
5 pamundur".

6 Është një akuzë, është një pretendim që duhet të jetë
7 plotësisht i pamundur. Kjo nuk nënkupton asnjë lloj barre
8 provuese. Kur bëhet një akuzë, apo vlerësimi i asaj akuze, kjo
9 kërkon prova *prima facie*.

10 Në dosjen tonë ne përmendim opinionin e veçantë të
11 Gjykatësit Kuris në çështjen e dytë Ramanauskas, ku ai bën një
12 analizë të shkurtër të të qenit plotësisht i pamundur. Unë e
13 pranoj se qëllimi i opinionit të këtij gjykatësi, në një farë
14 mase, ishte për të kritikuar këtë formulë për faktin se është
15 absolutiste. Por ky është testi, ky është kriteri ligjor,
16 sipas Dhomës së Madhe.

17 Është një klauzolë e të qenit plotësisht i pamundshëm dhe
18 në qoftë se bëhet kjo akuzë, i akuzuari duhet të përfitojë nga
19 mungesa e dyshimit.

20 Sigurisht, Trupi Gjykses vepron në bazë se ekzistonte
21 kërkesa e provave *prima facie*. Prokuroria ka të drejtë se
22 Trupi Gjykses ishte i vetëdijshëm për qasjen në këtë çështje.
23 Por nuk e zbatuan. Zbatuan një standard tjetër të tyre duke
24 kërkuar prova *prima facie* të nxitjes për vepra penale.

25 E vetmja barrë, sipas nesh, është që të ngrihej ky

1 pretendim se ishte plotësisht i pamundur.

2 Trupi Gjykses e pranoi --

3 Z. Gucati pretendoi se ishte nxitur dhe ai tha, këto janë
4 fjalët e tij dhe referenca ndodhet në dosjen e apelit:

5 "Në qoftë se" ajo që përshkruhet si "Rrufeja 1, 2 dhe 3
6 nuk do t'i kishte sjellë dokumentet në OVL UÇK duke na nxitur
7 që t'i bënim dokumentet të disponueshëm për publikun, nuk do
8 të kishim mbajtur konferencë publike. Nuk do të kishim pasur
9 materiale për të diskutuar. Ngjarjet e asaj dite ndodhën sepse
10 dikush në KSC, ZPS, na dha materialin dhe na nxiti që ta
11 paraqisnim atë në media".

12 Kjo ishte dëshmia që ai dha. Ai tha se dokumentet erdhën
13 me nxitjen e nënkuptuar dhe të drejtpërdrejtë që këtë
14 përmbajtje ta bënim të disponueshme para medias. Paketa e parë
15 erdhi me fjalët "vejani në dispozicion personit që flet me
16 median".

17 Në fakt, aktet e nxitjes, shtyrjes për vepër penale kanë
18 ndodhur. Kushdo që ka qenë pas këtyre paketave, ka ushtruar
19 një ndikim të tillë ndaj z. Gucati dhe unë po përdor fjalët e
20 çështjes Ramanuaskas, nxitur, e ka shtyrë, ndryshe vepra nuk
21 do të ishte kryer, sepse ata kanë dhënë mjetet dhe e kanë
22 nxitur për ta kryer këtë gjë.

23 Çështja ishte nëse personi që e ka kryer nxitjen, apo
24 personat e përfshirë, përfshinin ndonjë punonjës të ZPS-së apo
25 ndonjë person tjetër që ka vepruar sipas udhëzimeve të tyre.

1 Z. Gucati pretendon se është përfshirë një oficer, edhe
2 pse nuk e provon dot, dhe nuk kishte pse ta provonte në
3 përputhje me udhëzimin e Dhomës së Madhe të GJEDNJ në çështjen
4 Ramanauskak.

5 Ajo që ndodhi, sipas gjykimit të Trupit Gjykues, është që
6 a ka përdorur të kundërtën e barrës së provës se ai është
7 nxitur dhe kjo nuk është në përputhje me jurisprudencën e
8 Gjykatës Evropiane dhe jurisprudencën e nxitjes penale.

9 Pyetja tjetër që u bë kishte të bënte me nenin 401, nga i
10 nderuari Gjykatës Ambos. Siç e kuptova unë pyetjen, ju pyetët
11 nëse kishte ndonjë mospërputhje midis argumentit se objekti i
12 kërcënimit për qëllimet e Nenit 401 duhet të jetë person
13 zyrtar. Dhe dispozita që mjafton për një tentativë për të
14 penguar një person zyrtar, mjafton që të nënkuptohet vepra,
15 kur ka një mospërputhje midis objektit dhe përmes një
16 përpjekjeje dhe jo duke e kryer realisht.

17 Ne mendojmë se objekti i një kërcënimi duhet të jetë
18 zyrtar. Dhe nuk shohim ndonjë mospërputhje këtu, për faktin që
19 vepra mund të kryhet edhe pse nuk është kryer, është bërë një
20 përpjekje.

21 Në gjykimin e Trupit Gjykues, paragrafin 105 [sipas
22 përkthimit], Trupi Gjykues –

23 Më falni se gjeta të gabuarin.

24 Trupi Gjykues përcaktoi termin "pengon", tha:

25 "...termi 'pengoj' do të thotë të pengosh, të vonosh

1 kalimin e një mocioni apo ecurinë, progresin e diçkaje”.

2 Për mendimin e Trupit Gjykses, dhe ne nuk është se nuk
3 pajtohem me të, ka një dallim midis të penguarit, konkretisht
4 pengimin apo vonimit të miratimit të një mocioni apo progresit
5 të diçkaje dhe tentativës, përpjekjes për të vonuar apo për të
6 penguar. Dhe këtë dallim ata e përdorën, dhe përsëri ne
7 pajtohem me këtë, në paragrafin 653 të aktgjykimit.

8 Paneli vuri në dukje se në këtë rast ZPS-ja nuk ka vënë
9 në dukje ndonjë veprim që Dhoma e Specializuar apo zyrtar i
10 Prokurorisë “është penguar apo është vonuar në kryerjen e
11 detyrave të punës së vet si rezultat i veprimeve të të
12 akuzuarit”.

13 Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për ndonjë pengim apo
14 ndonjë vonesë në kryerjen e punës. Nuk kishte asnjë indikacion
15 se ZPS-ja është vonuar në kryerjen e funksioneve të rregullta
16 hetimore. Trupi Gjykses tha që “përdorimi i burimeve nga ZPS-
17 ja për t’u përgjigjur ndaj veprimtarive që pengojnë punën e
18 vet, është diçka e zakonshme. Përdorimi i këtyre burimeve nuk
19 është patjetër tregues i pengimit. Përdorimi i burimeve nga
20 ZPS-ja është një tregues i seriozitetit me të cilën ZPS-ja e
21 trajton çështjen” por erdhi në përfundimin se “nuk mund të
22 vinin në përfundimin se ndryshimi i këtyre burimeve ishte kaq
23 i madh sa çoi në pengesë”.

24 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Ndaloni këtu. Pikërisht ideja
25 dhe struktura e tentativës futet në lojë. Nuk diskutohet se

1 është kryer vepra. Ne bëjmë fjalë për tentativë, përpjekje për
2 kryerjen e një vepre. Dhe unë dua ta vazhdoj se kam një pyetje
3 tjetër për ju dhe e vlerësoj ndërhyrjen tuaj në këtë pikë.

4 Tentativa është një vepër e papërfunduar, si pjesë e
5 *actus reas*. Kemi një element mendor këtu në mendjen e personit
6 që orvatet të bëjë diçka, që përpiqet, tenton. Personi që
7 tenton, qëllimi i tij mund të jetë të pengojë procedura
8 zyrtare apo një person zyrtar duke kërcënuar persona privatë.
9 Kjo është struktura e përpjekjes.

10 Të kthehemi tek argumenti i dytë. Dhe në qoftë se nuk
11 pajtoheni, në rregull.

12 Argumenti i dytë është që, në dosjen tuaj të apelit ju
13 ngrini argumentin se tentativa tek 401 duhet të jetë një
14 aktivitet me një synim. Dhe ne duam që të shtjelloni këtë
15 interpretim, sepse kjo që po thoni, në fakt, tregon kërkesën e
16 një synimi konkret përmes strukturës së përpjekjes.

17 Ndoshta mund ta shtjelloni më tej këtë pikë.

18 Z. REES: [Përkthim] Së pari, të vij tek përfundimi i
19 përgjigjes sime. E di që ishte e gjatë, por ajo që doja të
20 thosha ishte kjo: për mendimin tonë, unë nuk shoh ndonjë
21 mospërputhje midis kërkesës që, për shembull, të ketë një
22 kërcënim ndaj ZPS-së apo ndonjë zyrtari dhe faktit që në disa
23 raste kërcënimi shumë mirë mund ta pengojë zyrtarin në punën e
24 tij, në rastet e tjera kërcënimi i drejtuar ndaj një zyrtari
25 mund të mos e pengojë. Mund të ketë pasur synim ta pengojë,

1 por, për arsye të ndryshme, për shembull, fakti që punonjësi
2 është i siguruar mirë dhe nuk ndjehet i frikësuar, në fakt ai
3 e kryen punën, e vazhdon punën e tij i papenguar.

4 Nuk shohim ndonjë mospërputhje midis faktit që vepra mund
5 të përfundojë kur bëhet përpjekja dhe parashtrimin tonë dhe
6 synimit -- Ju i keni të gjitha këto parashtrime në dosjen tonë
7 dhe Cadmani e plotësoi.

8 Lidhur me çështjen e dytë që ju po ngrini tani. Së pari,
9 ne themi se edhe pse duket qartë se ka shembuj kur një
10 tentativë parashikohet në Kodin Penal të Kosovës kur nuk
11 përfundohet vepra e plotë, nuk është ky rasti këtu.

12 Pra, 401(1) kur Gjykata konstaton se pengimi nuk është
13 kryer, është vetëm tentativë për kryerje, kjo mjafton për
14 *actus reus* për veprën e parashikuar në këtë dispozitë. Ka një
15 dispozitë të veçantë për vepra ku bëhen tentativa. Ne këtu
16 kemi një element të veprës. Në qoftë se tenton të pengosh, kjo
17 është një *actus reus* i mjaftueshëm.

18 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Një minutë, për ta sqaruar.
19 Nuk është plotësisht e saktë. Nuk është i plotë i kryer në
20 kuptimin e gjykimit. Por në kuptimin e përshkrimit të
21 elementëve të veprës.

22 Për t'u kuptuar drejtë, se sigurisht mund të thuash që
23 thotë "përpjekje tentative për të penguar një zyrtar". Ju po
24 thoni konkretisht se: mund të përpiqesh të pengosh një zyrtar,
25 por, gjithmonë duhet të përpiqesh të synosh një zyrtar. Këtë

1 po thoni.

2 Këtu ka një ndryshim, një shmangie në interpretim. Siç ka
3 thënë Trupi Gjykses, unë mund të synoj një person privat dhe
4 indirekt përpiqem, bëj tentativë, t'i drejtohem një personi
5 zyrtar. Por ju po thoni, edhe në këtë mënyrën e përpjekjeve
6 duhet gjithmonë të synosh një zyrtar. Kështu është?

7 Z. REES: [Përkthim] Po. Sigurisht, që Trupi Gjykses ndoqi
8 një interpretim tjetër. Ne parashtrojmë që ishte një
9 interpretim i gabuar ky i Trupit Gjykses. Ne themi se pjesë e
10 themelit të gabimit të këtij Trupi Gjykses është që ata e kanë
11 përdorur 401 se siguron që të pengohen detyrat e zyrtarit.
12 Kështu arritën në këtë interpretimin e tyre. Pra, në qoftë se
13 nuk pengohen plotësimi i detyrave zyrtare, qëllimi është i
14 vërtetuar duke lejuar që kërcënimi t'i drejtohet çdo njeriu.

15 Ne themi se kjo është e gabuar. Qëllimi i Nenit 401 është
16 në fakt të mbrojtë personin zyrtar nga veprime apo kërcënime të
17 dhunshme. Ky është qëllimi i këtij Neni. Dhe për këtë ne
18 mbështetemi tek çështja gjykatave të Kosovës Ajeti dhe pjesa
19 6.1 [sipas përkthimit] e gjykimit të kësaj çështje ku thuhet
20 që, qëllimi i pararendësit të 401 ishte pikërisht të mbrojtë
21 personin zyrtar nga veprimet e dhunshme.

22 Dhe ky është dhe mendimi i komentarit dhe ne kemi dhënë
23 edhe referencën. Në qoftë se kjo është e drejtë në këto dy
24 çështje, qëllimi është arritur vetëm duke kërkuar që objekti i
25 kërcënimit të personit zyrtar është që të mbrohet nga veprime

1 të dhunshme apo kërcënime të dhunshme.

2 Shpresoj që t'i jem përgjigjur pyetjes suaj.

3 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Ju iu përgjigjet pyetjes së
4 parë, por jo të aktiviteteve të orientuara nga qëllimi. Ky
5 ishte argumenti juaj i parë, që ngritët.

6 Mbase këtë mund të na e shpjegoni më tej.

7 Z. REES: [Përkthim] Ne themi se Kodi Penal i Kosovës e
8 njeh tiparin konkret specifik të synimit. Gjykatësi Barthe ka
9 një opinion të veçantë dhe ai e përcakton shumë mirë dhe unë e
10 miratoj këtë përmbledhjen e tij se si arriti në këtë qëndrim.
11 Dhe ne jemi dakord, pajtohemi.

12 Ne themi se qëllimi, veprimi i orientuar nga qëllimi ndaj
13 synimit, duhet të dalë në pah kur një vepër është kryer, është
14 bërë tentativa dhe është kryer. Kur ne tentojmë të bëjmë diçka
15 duhet që qëllimi duhet të jetë rezultati i asaj përpjekje.
16 Sepse në mënyrë të pavetëdijshme nuk tenton të bësh diçka.
17 Diçka e tenton kur do të arrish një qëllim. Unë do të bëj
18 diçka për të arritur atë qëllim.

19 E kryen veprimin për të arritur qëllimin dhe pastaj ose
20 ke sukses dhe e arrin ose në disa raste nuk e arrin për arsye
21 nga më të ndryshme, për shkak të ndërhyrjes së palëve të
22 tjera. Pra, nuk e arrin qëllimin. Por ti e ke tentuar ta
23 arrish. Parashtrimi ynë është që përpjekja për të penguar
24 domosdoshmërisht nënkupton një qëllim, një qasje që bazohet në
25 një qëllim.

1 Dhe kjo na shpie, siç thotë Gjykatësi Barthe kur ai
2 shqyrtoi kërkesën e synimit dhe ne e themi synim të
3 drejtpërdrejtë vetëm për Akuzën 3. E njëjta analizë na çon në
4 qëndrimin që për veprat e nenit 401, kur është në formën e
5 tentativës, po ashtu si pjesë e *mens rea* duhet të ketë një
6 qëllim, një objektiv.

7 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Nuk dua që ta zgjas më shumë,
8 megjithatë si kundërargument mund të them se neni 28 bën
9 përkufizimin e tentativës dhe përderisa ju pëlqen shumë Kodi
10 Penal i Kosovës, besoj që ka një debat të madh në qoftë se
11 doktrina e tentativës në vetvete nuk përfshin asnjë lloj
12 përfundimi.

13 Z. REES: [Përkthim] Është pikërisht ky debat, është ky
14 mospajtim që dy nga Trupat Gjykses i bëri që të thoshin kur
15 Kodi Penal i Kosovës i referohet synimit të drejtpërdrejtë,
16 flitet për tentativë, ndërkohë që Gjykatësi Barthe nuk u
17 pajtua me këtë sepse bën dallimin siç e kuptojmë ne dhe siç e
18 parashtrova pak më përpara. Dhe kuptohet që në qoftë se një
19 nen i veçantë kërkon një synim, ai ra dakord që Akuza 3 dhe
20 Neni 387 kërkonin që të kishte një qëllim dhe për këtë arsye u
21 përjashtua synimi eventual.

22 Mendojmë që e njëjta analizë duhet që të zbatohet edhe sa
23 i takon nenit 401, kur flitet për një veprim të mbetur në
24 tentativë, sepse qëllimi kryesor në tentativë është që ti të
25 arrish rezultatin ose produktin që ti dëshiron.

1 Nuk e di, në qoftë se me bie ndonjë gjë tjetër në mendje
2 kur të shtrihem për të fjetur lidhur me këtë argument,
3 sigurisht që do të bëj parashtrimet e nevojshme lidhur me të.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Kemi
5 mbërritur në fund të ditës së sotme. Do të rivazhdojmë nesër
6 në orën 9.30 duke filluar me parashtrimet e ZPS-së. Dhe më pas
7 do të vijojmë, siç e thashë edhe në fillim të seancës, do të
8 flasë ZPS-ja dhe pastaj do të dëgjojmë përgjigjet e Mbrojtjes
9 së z. Gucati dhe z. Haradinaj. Faleminderit për sot.

10 --- Seanca mbyllet në orën 17.17

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25